



Përkujtimi **I HIXHRETIT PROFETIK**



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

"Drita islame"
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

REDAKTORË
Andrin Rasha
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Ejup Lila

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXX i botimit
Nr. 08 (463)
Korrik, 2021

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,
nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.
Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

- 4 Përkujtimi i Hixhretit Profetik / Dorian Demetja
- 6 As engjëll, as djall / Qani Sulku
- 8 Lajme / Aktivitete



- 12 Për çfarë kemi nevojë (3) / Nuredin Nazarko
- 14 Njeriu është boshti i zhvillimit / Dr. Muhammed bin Musa Baba'ami
- 18 Termi dhikr / Ali Ynall
- 20 A jemi bletë, bilbila apo hardhuca?! / Prim.dr.med.sc. Ali f. Iljazi
- 22 Drejt Mekës / Namik Selmani
- 24 Familja, shkolla më e mirë për edukimin e njeriut / Samanta Hysa



- 26 Ismail Maçi, veprimtar i shquar tiranas (1885-1960) / Fak Kasolja
- 28 Xhamia e Nazareshës, Elbasan - Trashëgimi
- 30 Hatërmbetja nuk është një rrugë komunikimi / Aisa Kokiqi
- 32 Hurma, një frut i mrekullueshëm / Irfan Jëllmaz
- 36 Pëllumbat e shpellës



Përkujtimi **I HIXHRETIT PROFETIK**



Moskryerja e Haxhit, për të dytin vit radhazi, për shkak të pandemisë, do të mbetet gjatë në kujtesë dhe do të përmendet me një dhimbje të madhe në mesin e besimtarëve. Megjithatë, me anë të dritës së besimit, besimtarët e mirë mund të kuptojnë se asgjë nuk ndodh rastësisht në këtë botë dhe mund të bëhen të vetëdijshëm rreth aspekteve të brendshme të fenomeneve, si dhe të urtësive që qëndrojnë pas tyre. Në udhëtimin e tyre gjatë jetës, ata e studiojnë ekzistencën dhe atë që ndodhet pas saj me mijëra herë, duke i dhënë asaj kuptimin e vërtetë. Porë në këtë këndvështrim, shpreh me bindje se besimtarët anembanë botës, duke falënderuar në vazhdimësi Zotin, po bëjnë përgatitjet e duhura për festën e madhe që i pret, atë të Kurban Bajramit.

Kurbani vetë, është një shprehje përkushtimi, sakrifice, singjeriteti dhe nënshtrimi ndaj vullnetit hyjnor. Ky nënshtrim e përkushtim simbolizohet në mënyrë kulmore me dy profetët babë e bir, Ibrahimin dhe Ismailin, paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi ta. Praktika islame e flijimit daton nga Ibrahim (a.s.), kur ky hero i vërtetë

i historisë njerëzore, vendosi të flijojë djalin e tij, duke iu nënshtruar urdhrit të Allahut, i cili iu transmetua në ëndërr. Vendosmëria e Ibrahimit dhe gatishmëria e Ismailit për t'u sakrifikuar, ka qenë dhe mbetet një ngjarje e madhe në histori. I gatshëm të flijojë djalin, lindja e të cilit ishte fryt i lutjes dhe i shpresës në pleqëri, gëzim i pritur gjithë jetën, dhuratë e Zotit që i duhej kthyer Zotit. Shembulli i Ibrahimit (a.s.) paraqet rastin e ngritjes më të lartë shpirtërore dhe vullnetit të pathyeshëm, i cili të çliron nga çdo gjë që paraqet pengesë në rrugën e përgjegjësisë dhe të njeriut të ndërgjegjshëm. Nga sa u tha më lart, mund të dalim në përfundimin se sakrifica është ajo rrugë, e cila çon te mëshira e Zotit, pse jo edhe te miqësia e Tij, ashtu siç e fitoi titullin Ibrahim (a.s.) dhe u bë Halilullah (Mik i Allahut).

Ditët e bajramit shëmbëllojnë në ditë paqeje dhe gëzimi. Kjo festë e madhe e gëzimit, mëshirës, faljes, mirëkuptimit, vëllazërimit dhe paqes, i bekon të gjithë besimtarët shqiptarë me më shumë dashuri e respekt për njëri-tjetrin, me më shumë dëshirë e përkushtim për



të shfaqur vlerat e mirësisë e të solidaritetit njerëzor, si dhe për të kryer vepra të dobishme në shërbim të vendit dhe të ardhmes së tij. Hasan Es-Sibti tregon: "I dërguari i Allahut na urdhëroi të vishnim rrobat më të mira që mund të gjenim në dy Bajramet, të lyheshim me parfumin më të mirë dhe të bënim kurban kafshën më të mirë që mund të gjenim." (Hakimi) Në këtë drejtim, profeti Muhamed (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të) na këshillon që në Bajrame të hahet, të pihet dhe të shkëmbehen vizita, si dhe të tregohet gëzim e hare me qëllim që të manifestohet uniteti, toleranca, forca dhe vëllazërimi.

Bukuria dhe veçantia që e shoqëron këtë festë, është therja e kurbanit dhe shpërndarja e pjesës më të madhe të tij nevojtarëve. Është nga tradita e Profetit tonë për atë që ther kurban, që të hajë vetë nga mishi i kurbanit, t'i japë afërmve të tij dhe fukarenjve. Profeti Muhamed (s.a.s.) porositi: "Nga kurbanet, hani, shpërndani dhe ruani." (Buhari) Në jetën e njerëzve të varfër, që nuk janë në gjendje të mirë materiale, kuptohet qartë mirësia e bereqeti i këtij adhurimi. Kurbanit e mëson të pasurin që të

dhurojë nga pasuria e tij për të fituar kënaqësinë e Allahut. Ai nxit ndihmën e ndërsjellë dhe bën të ndihet në shpirt kënaqësia e dhurimit dhe e ndihmës. Veç kësaj, kurbanit ka vlera të veçanta edhe në jetën shoqërore. Kurbanit nxit dhe zhvillon shpirtin e vëllazërimit, të ndihmës, të sakrificës e të mbështetjes te njëri-tjetri. Ai ndihmon në zhvillimin e drejtësisë, siguron një ndihmesë domethënëse në kapërcimin e hendeqeve mes shtresave shoqërore dhe në njohjen, afrimin dhe shkrirjen mes individëve të niveleve të ndryshme.

Kurbanit mbart edhe plot vlera që ne ende nuk i njohim. Adhurimet, më shumë sesa për çdo vlerë e dobi jetësore, duhen kryer në radhë të parë për hir të Allahut. Në këtë kuptim, krahas çdo dobie individuale e shoqërore, kurbanit është një adhurim që kryhet për të arritur kënaqësinë e Krijuesit. Në Kur'an bëhet e qartë: "Tek Allahu nuk arrin as mishi e as gjaku i tyre, por tek Ai arrin bindja juaj..." (Haxh, 22:37). Kjo do të thotë se tek Ai nuk arrin asgjë nga ajo që jepet për Të dhe në emër të Tij, po që se nuk është rezultat i besimit dhe bindjes ndaj Tij.

A ENGJËLL, AS DJALL AS



Në mesin e krijesave dhe gjallesave të shumëllojshme, Zoti na përzgjedhi për të qenë njerëz dhe për të jetuar mbi faqen e tokës. Njeriu në jetën e tij nuk është imun dhe i mbrojtur nga gabimet, mëkatet apo gjynahet, sepse vet Allahu deshi që natyra e njeriut të ishte e tillë. Edhe pse engjëjt janë krijesa që kurrë nuk gabojnë dhe që gjatë gjithë kohës Allahun e lartësuar e madhërojnë dhe adhurojnë, prapë se prapë njeriu mbetet si krijesa më e përzgjedhur dhe më e përsosur, fakt të cilin vet Zoti e përmend në Kuran ku thotë: "Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur" (Sure Et-Tin, 4). Sado që të mundohet njeriu për të mos rënë në mëkate, nuk ka për t'ia arritur të bëhet një engjëll, por ajo për të cilën ai duhet të punojë fort, është që të mos bëhet një shejtan apo djall.

Kjo jetë na ka përballur me njerëz në dukje, në pamje, në aparençë, por që me sjelljet e tyre të bukura, me moralet e tyre të larta, me butësinë e brendshme që përshfaqin, me fjalët e zgjedhura, me fytyrat e buzëqeshura, me zemrat e pastra, me dashurinë e singertë dhe me përkujdesjen që tregojnë ndaj të tjerëve, shndërrohen në engjëj në kuptimin figurativ, pasi prej tyre nuk të vjen asnjë e keqe dhe asnjë dëm; ata përçojnë vetëm pozitivitet dhe mirësi kudo ku ndodhen. Shoqëria dhe kalimi i kohës me ta, merr vlerë shumë të madhe, sepse ata i përngjajnë një dyqani parfumesh, ku edhe nëse nuk lyhesh me to, do ta ndjesh patjetër aromën e këndshme të tyre. Në kohët e sotme, të tillë njerëz mund t'i rastisësh rrallë, por nëse të ndodh të takosh një njeri me cilësitë e sipërpërmendura, dije që ti je me fat, dhe nëse mundesh, qëndroji sa më pranë këtyre njerëzve dhe sa më gjatë të mundesh, sepse me siguri, ti do të fitosh shumë prej tyre, pasi ata kanë çfarë të japin dhe me mirësitë e shumta që reflektojnë, patjetër që do të ndikojnë edhe tek ty, për t'u bërë njeri më i mirë se ç'ke qenë më parë. Njerëz të tillë ta zbukurojnë jetën; të lumturojnë pa masë, të falin qetësi e siguri, paqe në brendinë e shpirtit dhe të nxisin për punë të mira e të begata. Kjo që sapo cekëm është vetëm njëra anë e monedhës që të ofron kjo dynja.

Kjo botë është e mbushur me njerëz që duken si të tillë në pamje apo në aparençë, por në vetvete janë një djall i madh, një shejtan kokë e këmbë, madje ka prej tyre që ia kalojnë dhe vet shejtanit të mallkuar. Ata janë vënë në shërbim të së keqes dhe punojnë natë e ditë për ta nxjerr atë më në pah. Ata si qëllim të tyrin kanë shkatërrimin, degjenerimin dhe kurthet djallëzore, prej të cilave duhet të ruhemi dhe

t'i kërkojmë Allahut të na mbrojë nga e keqja e tyre, ashtu siç porosit Ai në dy prej sureve të fundit të Kuranit (Sure Felek dhe Nas). Vuajtjet më të mëdhaja njeriut ia shkakton njeriu, Ç'është më e keqja, në të shumtën e rasteve, i afërmi i tij, që mund të jetë i afërm nga gjaku, koleg, shok/shoqe, pra një i njohur, i cili nga xhelozia që kutërbon brenda tij, nga e keqja që ka zënë rënjë në zemrën e tij, verbohët dhe nuk kontrollon dot se çfarë është duke bërë dhe bëhet vegël në duart e shejtanit dhe lëviz sipas urdhrave të tij, ashtu siç rrotullojmë zinxhirin rreth gishtave apo dorës. Këta njerëz, që nuk e meritojnë të quhen të tillë, nuk ngopen së lënduari të tjerët; së hapuri plagë e së godituri me plumbat e fjalëve, me vrerin që lëshojnë; me intrigat që thurrin dhe me planet shejtaneske në adresë të të tjerëve. Edhe pse e dinë se çfarë lloj njeriu janë, këmbngulin dhe nuk heqin dorë nga rruga e gabuar në të cilën rendin.

Prandaj o njeri, ti je rob i Zotit, dhe sillu si i tillë! Mos u bëj si shejtani që ngriti kokë mbi urdhrat e Allahut – Krijuesit suprem, dhe meritoi mallkimin e Tij, duke humbur njëherë e përgjithmonë mëshirën e Zotit, jo vetëm ai, por edhe ata që e ndjekin atë dhe vesveset dhe cytjet e tij. Për çdo gabim apo gjynah, pendohu sa më parë dhe pastroje veten, fshiji mirë njollat dhe gjurmët që kanë lënë mëkatet dhe mundohu ta kontrollosh veten në çdo veprim që bën, për të evituar sa më shumë rënien në grackën e djallit. Mos e ushqe veten me mendime negative dhe mos injekto brenda teje doza smire dhe hakmarrjeje ndaj të tjerëve. Ti ke një Zot që sheh dhe dëgjon gjithçka; Ti ke një Zot që kujdeset për ty deri në detajet më të imta; Ti ke një Zot që ua di të brendshmen dhe të jashtmen gjithkujt. Dorëzoja çështjet e tua vetëm Atij dhe jti i sigurt dhe i qetë në përcaktimin e Tij!

Lufto me veten dhe egon tënde dhe mundohu të paraqitesh para njerëzve ashtu siç je në të vërtetë, ashtu siç je në realitet, ashtu siç je kur je vetëm, pa praninë e askujt. Pranoji veset që mund të kesh dhe që mund të të kenë marr peng, ose që ke krijuar varësi ndaj tyre dhe përpiqu të shpëtosh prej tyre në një formë apo në një tjetër! Mos iu afro shejtanit dhe mos hyr në asnjë portë që të shpie drejt tij, sepse ajo që premtan ai është mashtrim në këtë botë dhe humbje e shkatërrim përfundimtar në botën e përtejme. Këto fjalë që sapo thamë, së pari ia drejtojmë vetes, pastaj të tjerëve, me qëllimin e mirë, për të reflektuar dhe për t'u përmirësuar. Allahu na bëftë nga ata që ndjekin dhe veprojnë më të mirën e asaj që dëgjojnë apo lexojnë! Amin



1

VIZITË E TEOLOGJËVE DHE AKTIVISTJËVE NGA ZVICRA

Një grup studiuesish, teologësh dhe aktivistësh nga Zvicra, vizituan Komunitetin Mysliman të Shqipërisë. Ata u pritën nga Kryetari Spahiu, i cili i njohu ata me veprimtarinë e institucionit që drejton, me kontributin dhe vlerat paqësore të islamit, dhe se si përqohet ato te qytetarët në vendin tonë dhe më gjerë.

Pjesë e bisedës ishin edhe literatura dhe botimet e KMSH-s.

Institucionet arsimore dhe edukuese si medresetë, Universiteti BEDER, aktiviteti fetar dhe edukues i xhamive etj.

Iniciuesi i kësaj vizite ishte Dr. Christian Walti, Teolog i krishter dhe lektor në Universitetin e Bernës.

Ky grup vizitorësh përbëhej nga 13 persona (zvicrianë), por me përkatësi të ndryshme fetare, disa prej të cilëve teologë aktivë.

Ata mbetën të impresionuar nga kjo vizitë dhe vlerësuan shumë harmoninë fetare në vendin tonë. Gjë për të cilën edhe kishin kureshtje të madhe.

Interesit të tyre rreth fesë islame, dialogut ndër fetar, paqes e sigurisë që përcjell feja islame në vendin tonë, iu përgjigj me shumë dashamirësi kryetari Spahiu.

3

KONKURSI I PARË I EZANIT I ORGANIZUAR NGA KMSH

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë organizoi konkursin "Thirrja e Ezanit", konkurs i zhvilluar për herë të parë në rang kombëtar. Në këtë konkurs morën pjesë kandidatë nga e gjithë Shqipëria, të grupmoshave 15 deri në 25 vjeç.

Konkursi kaloi nëpër tre faza: thirrja nëpër ambientet e xhamive të myftinive, seleksionimi lokal, sipas çdo myftinie dhe finalja.

Ditën e shtunë, 17 korrik 2021, në ambientet e Universitetit BEDER u zhvillua finalja.

Në konkursin final morën pjesë; Kryetari dhe Nënkrjetari i KMSH-s, myftinj të rrethëve dhe Rektori i Kolegjit Universitar "BEDER", Prof. Ferdinand Gjani.

Juria që bëri vlerësimin e konkursit final ishte: Jamal Safarti, pedagog BEDER, Lauren Luli, Myfti i Tiranës dhe Elton Karaj, Imami i Xhamisë Et'hem Beu.

Sipas vlerësimit final të jurisë, midis 25 konkurrentëve nga i gjithë vendi, z. Klodian Tota nga Peshkopia, u vlerësua me çmimin e parë, z. Haxhi Duka nga Elbasani, u vlerësua me çmimin e dytë dhe z. Toni Hymeraj nga Fushë-Kruja, u vlerësua me çmimin e tretë.

Për të gjithë kandidatët pjesëmarrës në konkursin final u dha nga një dhuratë simbolike, për tre çmimet e para dhuratat ishin më specifike.



2

KOLEGJI UNIVERSITAR "BEDËR" DIPLOMON BREZIN E TETË TË STUDENTËVE

278 studentë mbyllën me sukses rrugëtimin akademik duke u diplomuar në 8 programe bachelor dhe 6 master në Kolegjin Universitar Bedër.

Në ceremoni, krahas studentëve që u diplomuan dhe anëtarëve të stafit, ishin të pranishëm edhe shumë personalitete nga brenda dhe jashtë vendit.

Pas fjalës së rastit nga Rektori, Prof. Ferdinand Gjani, i cili uroi të diplomuarit për suksesin e arritur, studentët i përshëndeti edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu.

"Në konceptet bashkëkohore, universiteti i jep studentit një profesion për të fituar lirinë. Në islam është diçka më shumë se kaq, në Universitetin BEDËR, ku ju mbaruat studimet, pa diskutim që keni marrë diçka më shumë se një profesion. Keni marrë vlerat që mbart ky Universitet, keni marrë një formim profesional shumë të mirë, por edhe disa vlera që jo në çdo universitet merren. Dua t'ju them se, ju jeni njerëzit që përfaqësoni të ardhmen e vendit tonë, ju jeni ashtu siç ka emrin universiteti, Hënë e plotë që ndriçon shumë. Merrni seriozisht këtë gjë, vlerësoni dhe do të keni bekimin e Zotit, të familjeve tuaja dhe gjithë shoqërisë.", tha Kryetari Spahiu ndër të tjera në fjalën e tij.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ju uron suksese të mëtijshme çdo të diplomuari në BEDËR!

6

SHPËRNDARJA E DHJETRA PAKOVE PËR FAMILJET NË NEVOJË

Thirrjes së Komunitetit Musliman të Shqipërisë për mbledhjen e kurbaneve, dhe më pas shpërndarjen e tyre te familjet në nevojë, i janë përgjigjur shumë qytetar rezident në Shqipëri dhe ata të diasporës.

Zyra e Gruas pranë KMSH bëri të mundur identifikimin e familjeve në nevojë dhe shpërndarjen e dhjetra pakove me mish kurban.

"Kurbani është adhurim ashtu sikurse është edhe gëzim. Falënderojmë Zotin që na bëri të mundur të bëhemi ndërmjetës të amanetit të besimtarëve për familjet e varfëra.

Ne e dimë që nevojat janë të shumta përgjatë gjithë vitit, por elhamdulillah që na u dha mundësia t'i gëzojmë disa familje në këtë Kurban Bajram.

Dua të falënderoj shqiptarët që jetojnë në Connecticut të SHBA-ve, "Albanian American Muslim Community" të cilët për të disatin vit radhazi na e besojnë në amanetin e tyre, ashtu si edhe këto kurbane.

Po ashtu falënderoj edhe besimtarët e Xhamisë Reinach në Zvicër që ishin ndër kontribuesit kryesorë në këtë nismë.

Zoti i shpërbleftë ata që japin, Zoti ua lehtësoftë dhimbjen që shkakton varfëria atyre që marrin.

Ne, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë përpiqemi me sa mundemi të gjendemi sadopak pranë shtresave të tilla sociale.

Ju deshiroj bajram të gëzuar të gjithëve." u shpreh Përgjegjësjë e Zyrës së Gruas, znj. Fatma Karaj.

I gjithë procesi, nga gjetja e kurbaneve, therja, paketimi, dhe vendi i shpërndarjes u organizua nga Medreseja e Tiranës.



4

FALJA E KURBAN BAJRAMIT NË SHESHIN SKËNDERBEJ, TIRANË

Mijëra besimtarë myslimanë, më datë 20. 07. 2021, falën namazin e Kurban Bajramit në sheshin "Skënderbej", në Tiranë, dhe mijëra të tjerë në sheshet kryesore të çdo qyteti të vendit.

Festimet e Kurban Bajramit filluan që në orët e para të mëngjesit me faljen e namazit të sabahut.

Më pas programi i Bajramit filloi me këndimin e një pjesë nga Kur'ani Famëlartë, të cilën e përcolli imami i xhamisë "Xhura", z. Bilal Teqja.

Duke vijuar me fjalën e Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili përcolli për të pranishmit urimet dhe përshëndetjet e kësaj dite gëzimi për të gjithë besimtarët myslimanë shqiptarë.

Mesazhi i Kryetarit Spahiu për qytetarët në këtë bajram, u fokusua te familja dhe problemet sociale.

"Kjo festë, ashtu si çdo festë në fenë islame, mbart kuptim dhe vlera të larta.

Festat në islam nuk janë festa konsumi, janë adhurim dhe gëzim njëkohësisht.

Kurban Bajrami është festa që na kujton se sa i lartë duhet të jetë devocioni i njeriut ndaj Zotit. Në shoqërinë e sotme moderne, jeta është shumë e vrullshme." – shtoi, ndër të tjera, Kryetari.

Në ligjëratën e rastit, Nënkryetari i Komunitetit Mysliman, z. Taulant Bica, u fokusua tek kujdesi dhe vëmendja që duhet t'i kushtojmë adhurimit ndaj Zotit dhe respektit ndaj njëri-tjetrit.

Simbolika e kësaj dite është prerja e Kurbanit për hir të Zotit. Kjo është një mënyrë adhurimi që Zoti ja ka kërkuar gjithmonë njerëzimit.

Profeti Muhammed (a.s.) ka thënë : "Preni Kurban sepse prerja e kurbanit është shembulli i atit tuaj, Ibrahimit. "

Prezantimi i ceremonisë së Kurban Bajramit u bë nga, z. Ejup Lila, Drejtori i Kabinetit KMSH.

Më pas besimtarët e pranishëm në shesh u shpërndanë për të festuar me familjet dhe të afërmit e tyre.





5

KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË HAPI DYERT PËR TË PRITUR URIMET ME RASTIN E KURBAN BAJRAMIT

KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË HAPI DYERT PËR TË PRITUR URIMET ME RASTIN E KURBAN BAJRAMIT

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti urime nga përfaqësuesit e komuniteteve fetare të vendit tonë, nga Kryetarja e Komitetit Shtetëror për Kultet, znj. Loreta Aliko, së bashku me stafin (anëtarët), Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj, gazetari i mirënjohur, z. Lutfi Dervishi, akademikë, drejtues të institucioneve qëndrore e lokale, publike e private.

Urimet e tyre i përcollën edhe ambasadorët e vendeve të Bashkimit Europian dhe vendeve të tjera mike, të akredituara në Tiranë. Në mesazhet e tyre drejtuar kreut të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiut, ata shprehën urimet dhe përshëndetjet e tyre të singerta, si dhe vunë theksin te simbolika e sakrificës që përcjell Kurbanin në vendin tonë dhe mbarë botën.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë falënderon të gjithë ata që morën pjesë në këto vizita si dhe të gjithë shqiptarët që kanë dërguar mesazhe urimi me rastin e kësaj feste.



Për çfarë kemi nevojë (3)

5) Vetëpërmbytja.

Gjendjet që kalojmë dhe situatat ku mund të përfshihemi nxisin vrullin e emocioneve. Zemra e njeriut është në trazim të vazhdueshëm. Luhatjet e emocioneve dhe përjetimeve në brendinë e saj janë vullkan. Ndryshe nga vullkani njeriu zotëron arsye. Vullkani kur arrin kulmin e aktivitetit të brendshëm do ta çajë rrugën për të zbrazur magmën në sipërfaqe. A mund të veprojmë dhe ne kështoj? Asnjëherë nuk duhet të biem viktimë e emocioneve që mund të na shkaktojnë ngjarje jo të këndshme. As viktimë e thashethemexhinjëve që fryjnë dhe nxitin reagime të fuqishme emocionale. Emocionet që dominojnë në të tilla gjendje e situata janë urrejtja, zemërimi, inati. A mund të jetë i pastër, i kulluar dhe mbi të gjitha i drejtë veprimi në të tilla gjendje? Nuk mund të thotë kush po. Kur shohim se emocionet po mbizotërojnë arsyen duhet të gjejmë forcën brenda vetes për t'u tërhequr dhe kthjelluar. Pasandaj të analizojmë me qetësi situatën dhe vendimi përfundimtar të jetë i drejtë që të mos ketë padrejtësi dhe brerje ndërgjegje më pas. Kjo vlen edhe për çështjet që nuk mund të zgjidhen ndryshe vetëm se me rrugë institucionale. Duhet të jemi të vetëpërmbytur për të mos marrë mbi supe gjëra të cilat jo vetëm që nuk i rregullojmë, por mund t'i katranosim nën ndikimin e emocioneve. Fuqia e arsyes duhet të na shoqërojë në çdo hap të veprimtarisë jetësore. Veprimi duhet të bazohet mbi fakte konkrete dhe jo mbi fjalë të thëna lart e poshtë. Vetëpërmbytja zhvillohet në vazhdimësi. Zgjerimi i njohurive sjell dhe zgjerim të këndvështrimit. Zemra do të gjykojë më qartë. Ndërgjegja do të jetë më e qetë. Mbi të gjitha do të jemi më afër së drejtës. Ky duhet të jetë qëllimi që duhet të na udhëheqë. Përballë qëllimit emocionet duhet të zbuten, të shtrohen e të kanalizohen në rrugën e arsyes.

6) Vendosmëria.

Njeriu është njeri për aq sa mund të zgjedhë mbi cilat shina do ta vendosë mënyrën e të jetuarit. Cilado të jetë zgjedhja duhet vendosmëri. Disa janë të vendosur të ndjekin zgjedhjen jo mbi bazë principesh, por mbi bazë dëshirash krejt materialistike. Disa janë të vendosur të ndjekin zgjedhjen mbi bazë principesh dhe të shkrijnë jetën e tyre në shërbim të virtytshmërisë. Të jetosh me frymën e virtyteve në një mjedis që qëlon nga ecja pa busull në terrenin ku ka vetëm mundësi e pamundësi dhe jo duhet e nuk duhet, nuk është aq e thjeshtë sa mund të duket. Të duhet të përballosh ortekun e padukshëm të përveçimit nga masa. Të jetosh ndryshe nga të tjerët kërkon energji të madhe. Të qenit ndryshe nuk duhet keqkuptuar. Të qenit ndryshe do të thotë që jeta jote është vendosur mbi bazën e virtyteve dhe ushqehet prej tyre, në kohën kur jeta e të tjerëve ushqehet nga gjithfarë dëshirash që plotësohen në kundërshtim me normat morale dhe etike. Nëse ke nisur të ecësh në rrugën e virtyteve apo je duke ecur në të, mos e ngri veten në piedestale të panevojshme. Vendosmëria për të ecur në këtë rrugë është dhuratë që të jepet. Mos mendo se je fort i zoti apo e zonja. Dobësia që karakterizon njeriun përballë dëshirave të ethshme për konsum është tregues i mjaftueshëm për të kuptuar se sa shpejt mund të thyhet vendosmëria jonë. Nuk duhet të kacagjelosesh dhe të përcmosh të tjerët që nuk janë duke ecur në rrugën

tënde. Askush nuk e di përfundimin. Sot mund të ecësh në rrugën e virtyteve, por ndoshta nuk e meriton të vazhdosh udhëtimin në të dhe një ditë të bukur mund ta gjesh veten në vorbullën e konsumerizmit materialistik. Sot mund të jesh në vorbull, po ndoshta dashuron virtytet dhe del prej vorbullës dhe ecën me zemër të pastër në një rrugë që as e kishe ëndërruar më herët. Jeta është plot të papritura. Prandaj mos u nxito të mbivlerësosh apo të zhvlerësosh. Rëndësia themelore qëndron në vendosmërinë për të ecur në rrugën e virtyteve, pavarësisht vështirësive që mund të hasësh. Ndeshim njerëz që edhe pse kanë nisur apo janë duke ecur në rrugën e virtyteve, kanë një hendek në brendësinë e tyre që ende nuk kanë arritur ta kapërcejnë. Është hendeku mes mënyrës së të jetuarit para dhe pas ecjes në këtë rrugë. Kjo është vështirësia më serioze për këdo që ka kthyer timonin e anijes së vet drejt mënyrës së re të të jetuarit, por që ende ndjen nostalgji për bregun e vjetër prej të cilit u shkëput. Këtu duket qartë vendosmëria. Nëse ke vendosur të shkëputesh nga bregu i vjetër dhe të shkosh drejt një kontinenti të ri ku të pret jeta e re mbi bazë virtytesh, mos lakmo me zemër mënyrën e vjetër të të jetuarit dhe të të detyrojnë rrethanat e jashtme të qëndrosh në kufijtë e virtytit. Vendosmëria është në zemër. Nëse nuk e gjen aty nuk e gjen askund tjetër. Njeriu nuk bëhet i vendosur në rrugën e virtyteve për inat të ndokujt. Bëhet i vendosur nëse vërtet i dashuron virtytet. Nuk mund të hysh në këtë udhë dhe një pjesë të ditës apo të natës të jetosh me virtytet e pjesën tjetër të shkelësh me të dy këmbët normat morale dhe etike. Nuk mund të jesh ditën bamirës e natën hajdut. Vendosmëria duhet pikërisht për të shmangur gjendje të turbullta, të paqarta, ku njeriu nuk di se kujt i përket. I përket jetës së virtytshme apo skllavërimit fund e krye nga dëshirat materialiste?

7) Vendosja e ekuilibrit në jetë.

Mesataria është çelësi që hap derën e harmonizimit mes dëshirave dhe mundësive, mes realitetit dhe ëndrrave. Në jetë çdokush ëndërron më të mirën, që në përfytyrimet e zakonshme lidhet kryesisht me mirëqënien materiale. Pa diskutim që mirëqënia materiale është prej domosdoshmërisë së të jetuarit mirë. Por kjo nuk duhet kthyer qëllim themelor i jetës. Njeriu ka për detyrë të harmonizojë nevojat shpirtërore me ato fizike. Harmonia dhe paqja që buron prej saj vijnë vetëm kur fjalët dhe veprimet kalojnë në sitën e moralit dhe etikës. Kur njeriu respekton hakun ndaj vetes dhe hakun e tjetrit. Njeriu duhet të vendosë harmoninë mes të drejtave dhe detyrave, mes angazhimit familjar dhe shoqëror. Të arrish ekuilibrin nuk është e lehtë, por as e pamundur. Ruajta e mesatarisë nëse e ke arritur është edhe më e vështirë. Kjo sepse njeriu është gjithmonë i uritur për më shumë. Vazhdimisht gjendet nën trysinë për ta cënuar harmoninë e arritur me mund e sakrificë. Ka vetëm një rrugë për ta ruajtur mesatarinë. Thellim në dituri. Sa më i ditur aq më i kthjellët për harmonizimin e elementëve që ndërtojnë strukturën e të vepruarit në jetë.

Të jetosh nuk është thjesht të presësh kohën kur vjen largimi nga kjo jetë. Koha fizike mes lindjes dhe vdekjes është mundësia e vetme e njeriut për të qënë njeri si qenie dhe jo thjesht si strukturë fizike e konsumatore.

NJERIU ËSHTË BOSHTI I ZHVILLIMIT NË METODOLOGJINË E KUR'ANIT

Gjëja e parë që lëviz mendjen e studiusit, ndërsa ai shqyrton “Metodat e zhvillimit në Kur’anin Kerim”, është vlera dhe rëndësia e temës. Pastaj përfshirja, nga ana e saj, e të gjitha aspekteve të jetës dhe e përcaktimeve të sakta të shkencave pa asnjë përjashtim nga njëra anë, dhe përfshirja e temës së hollësishme dhe të përqëndruar nga një anë tjetër. Në mënyrë të veçantë ai trajton “formën dhe metodën” dhe jo “subjektin e brendinë”, dhe kjo është pikërisht në Kur’anin Kerim dhe jo në të tjerat prej burimeve të legjislacionit Islam, të tilla si, Sunneti dhe Ixhmai.

ISLAMI DHE ZHVILLIMI

Njeriu mund të pyesë, “Cila është urtësia në qënien e metodave të zhvillimit në Kur’anin Kerim, urtësia e koncepteve bazë të tyre, e formave dhe e shkaqeve të

mungesës së tyre, si dhe urtësia e të gjitha boshteve që lidhen me to të jenë të pashpjeguar në një sure të vetme ose nën një titull të vetëm, por janë të shpërndara në të gjithë Kur’anin Kerim në forma e mënyra të ndryshme?

Nuk ka dyshim se Kur’ani Kerim është Libër “jete” dhe nuk është në natyrën e jetës që të ndahet e të jetë e pjesshme dhe e njëanshme. Diskutimi rreth zhvillimit është një diskutim që ka të bëjë me të gjitha aspektet e jetës, çfarëdo qofshin ato, edukative, ekonomike, ideologjike, shoqërore dhe politike. Thjesht ta grumbullosh zhvillimin nën një titull të vetëm ose nën një sure të vetme do të ishte ikje dhe shmangie prej metodologjisë më shembullore të trajtimit të këtij subjekti të rëndësishëm.

Si rrjedhojë, “përfshirja e zhvillimit dhe integriteti i tij” është karakteristika më e dalluar e zhvillimit

në Kur'anin Kerim. Metoda e trajtimit duhet të jetë nëpërmjet ndjekjes së një metodologjie përfshirëse dhe integruese. Natyrisht nga kjo nuk kuptohet që tema të mbytet në fjalë të pafundme të përgjithshme, por as të mos shihet si një sinonim për të gjitha temat, duke marrë prej tyre dhe duke iu referuar atyre, edhe në qoftë se ato do të ishin të largëta. Sepse një përgjithësim i tillë do të ishte garant për humbjen e metodologjisë dhe e strukturës dhe do të ishte prishje e synimit dhe e kuptimit.

Kur'ani Kerim në prezantimin e tij të fushave të ndryshme të zhvillimit dhe të llojeve të tij është "mjaft i saktë" dhe "tepër i qartë" pa ngatërresë e pa paqartësi. Për shembull, lidhur me diskutimin rreth zhvillimit bujqësor, është Fjala e Allahut, "Dhe një shenjë për ta është toka e vdekur. Ne i japim jetë asaj dhe Ne nxjerrim prej saj drithëra dhe kështu prej tyre ata hanë. Dhe Ne kemi bërë në të kopshte hurmash dhe vreshta dhe kemi bërë në të edhe burimet e ujit të derdhen me vrull. Me qëllim që ata të mund të hanë nga frutat e saj në të dhe nuk e bënë gjithë këtë duart e tyre. A nuk do të falënderojnë ata?" (Ja'sin, 36: 33-55). Këto Ajete shfaqën limitet e Punës së Allahut, por nuk e mohuan punën e njeriut dhe as përpjekjen dhe njohjen e tij, çështjen e disa konceptimeve të gabuara ndaj ligjeve të kozmosit. Sepse rezultati i njeriut është prej shkaqeve të lulëzimit të kërkuar e të dëshiruar dhe se puna e tij është prej parathënieve të detyruara të zhvillimit. Fjala e Allahut, "... Ve ma amilet-hu ehdihi (dhe nuk e bënë të gjithë këtë duart e tyre)", nënkupton këtë: "le të hanë ata prej asaj që e bënë duart e tyre prej mbjelljes dhe plugimit me të cilat ata u lodhën".

Pastaj, "falënderimi" gjithashtu është njëri prej shkaqeve dhe njëra prej parathënieve. Si rrjedhojë, gjysma e parë – domethënë njohja dhe puna- janë të kuptueshme dhe të qarta tek të gjithë popujt e shoqëritë edhe sikur ata të ishin mohues apo ateistë. Kurse gjysma e dytë mban një shtojcë të spikatur dhe të mahnitshme, e cila është "falënderimi ndaj mirësisë". Kështu bëhet i qartë dallimi thelbësor midis metodologjisë së Kur'anit dhe midis metodologjive të tjera ideale. Allahu xh.sh thotë: "...Kujto kur Zoti juaj shpalli: "Nëse ju falënderoni, Unë do t'ju jap akoma më shumë, por në qoftë se jeni mosmirënjohës duke mohuar, atëherë me të vërtetë që ndëshkimi im është i rreptë". (Ibrahim, 14. 7). Gjithashtu Allahu thotë: "A nuk e shohin ata se Ne kemi krijuar për ta nga ato gjëra që kanë krijuar Duart Tonë- bagëtisë, kështu ata i kanë nën sundim. Dhe Ne ua kemi nënshtruar ato atyre. Kësisoj disa prej tyre ata i kanë për të udhëtuar dhe disa i hanë". Dhe për ta ka në të përfitime (të tjera veç këtyre) dhe marrin për të pirë (qumësht). A nuk do të falënderojnë pra?". (Ja'sin, 36: 71-73).

Kur studiusi zhytet në njërin prej Ajeteve Kur'anore

lidhur me zhvillimin, mbetet i trullosur nga kjo "saktësi" dhe nga kjo "qartësi". Kjo është një karakteristikë e dytë e metodologjisë së Kur'anit në trajtimin e temës së zhvillimit.

Si rrjedhojë, ne shënojmë këtu se karakteristikat më të dalluara në metodologjinë e Kur'anit lidhur me zhvillimin janë katër. Ato janë: "Gjithëpërfshirja", "integriteti", "saktësia" dhe "qartësia".

"Zhvillimi" prej hyrjes ekonomike të tij është një fazë e zhvilluar e cila vjen pas fazës së rritjes ekonomike dhe ka kuptimin e rritjes së përqindjes së prodhimit të përgjithshëm e krahasuar me çmimet e qëndrueshme, domethënë me rritjen reale të të ardhurave kombëtare. Kështu, vendi i cili e bazon ekonominë e tij mbi prodhimin dhe eksportin e naftës, gazit, qymyrit, kafesë ose të hekurit duhet ta realizojë zhvillimin ekonomik nëpërmjet rritjes së prodhimit të këtyre lëndëve në tregjet botërore. Por kjo rritje e shpejtë dhe e paqëndrueshme nuk çon medoemos në zhvillimin ekonomik, gjë e cila bëhet e ditur nëpërmjet tre termave: 'Plani, të ardhurat reale kombëtare dhe afatgjatësia'. Zhvillimi ekonomik nuk duhet të kuptohet si një ndryshim i plotë sipërfaqësor i përkohshëm që kufizohet tek një element i caktuar prej elementeve të zhvillimit, por ai është një "plan" i ndërlikuar dhe i pleksur që synon një ndryshim thelbësor në ngritjen ekonomike, që shtrihet duke prekur të gjitha marrëdhëniet ekonomike, dhe rezulton në rritjen e përqindjes së prodhimit në sasinë e efektshmërisë së përdorimit të të ardhurave kombëtare e botërore dhe të nivelit teknologjik në dispozicion.

ELEMENTET E ZHVILLIMIT NË KUR'ANIN KERIM

Do të ishte e vështirë që t'i përkufizosh të gjithë elementet e zhvillimit që kanë ardhur në Kur'anin Kerim, por ama një analizë e hollë paraprake do të na i shfaqte disa prej atyre elementeve, të cilët ndoshta do të ishin më të rëndësishmit. Ato janë sa vijon: Kapitali, pasuritë natyrore dhe mekanizmat (ose teknologjia, siç njihet sot), njeriu, falënderimi, koha, e Padukshmja, administrimi, planifikimi, shkenca, puna dhe orientimi i kapaciteteve.

Nuk ka dyshim se, në qoftë se ne do të përpiqeshim që t'i klasifikonim këto elemente në një trajtë metodologjike, ne do të gjenim se ato ndahen në tre boshte, të cilat janë:

- Të Ardhurat: Këto përfshijnë kapitalin, pasuritë natyrore dhe kohën.

- E Padukshmja: Kjo përfaqëson Vullnetin e Zotit, Fuqinë e Tij dhe falënderimin ndaj mirësive të Tij.

- Njeriu: Në këtë përfshihen dëshira, planifikimi, dija, puna dhe orientimi i kapaciteteve.

Këtu ne do të përqëndrohemi mbi "Qënien e njeriut si një bosht në zhvillim duke u bazuar në

metodologjinë e Kur'anit". Do të nisemi prej majes -kulmit- të zhvillimit dhe do t'i nxjerrim e deduktojmë këto elemente, sipas kontekstit duke iu përmbajtur Tefsirit-komentit Kur'anor- dhe rregullave të tij. Pikërisht me të njëjtën mënyrë mund të trajtohen edhe shembujt e tjerë. Elementet janë sa vijon:

ELEMENTET E ZHVILLIMIT NË TREGIMIN E DHUL-KARNEJNIT

Në tregimin e Dhul- Karnejnit, i cili ka ardhur i detajuar në pjesët e fundit të Sures kehf, ne gjejmë elementet themelore të zhvillimit që vijnë në mënyra të ndryshme. Ato janë prej shembujve më të mirë të cilët na shtojnë neve për tek kjo temë. Prej atyre është shembulli se, Dhul-Karnejni kur arriti "mes dy pengesave" (Kehf, 18: 93), domethënë mes dy maleve, ai gjeti aty një popull "që mezi kuptonin ndonjë fjalë" (Kehf,18: 93). Allahu e vendosi Dhul-Karnejnin në tokë dhe i dhuroi atij rrugë e mjete për të arritur çdo gjë. Këtu ne vërejmë takimin midis një populli që i përkiste një shoqërie jo në zhvillim dhe midis një burri të madh i cili erdhi prej një mjedisi në zhvillim. Njerëzit karakterizoheshin me cilësitë e dobësisë, pafuqisë, prapambetjes dhe paditurisë, dhe të cilët nuk kishin mundur që t'u kundërpërgjigjeshin Xhuxh Maxhuxhëve, të cilët kishin sunduar mbi ta dhe kishin rrënuar e prishur tokën e tyre.

Ndërsa lidhur me Dhul-Karnejnin, ai kishte arritur kulmin e zhvillimit. Allahu e vendosi atë në tokë dhe i dhuroi rrugë e mjete për të arritur çdo gjë; domethënë, i dhuroi pushtet me baza të forta, ia lehtësoi atij shkaqet e sundimit dhe të pushtimit, shkaqet e ndërtimit dhe të zhvillimit, shkaqet e mbretërimit dhe të pasurimit, si dhe gjëra të tjera që lidhen me njerëzit duke ua dhënë atyre mundësinë të vendosen me autoritet në tokë në këtë jetë.

Kështu, "Pastaj ai ndoqi një rrugë". (Kehf, 18: 85). Domethënë, e nënshtroi atë që iu dhurua atij prej mirësive duke e vënë në shërbim të qëllimit dhe synimit të tij dhe duke mos e lënë të humbiste e të shkonte më kot. Sigurisht në shkencën e administrimit, orientimi i kapaciteteve, vendosja e qëllimit dhe përcaktimi i objektivave janë më të rëndësishmet e fazave të planifikimit dhe të projektimit strategjik për hir të një zhvillimi të vazhdueshëm e gjithëpërfshirës. Ajo që bie në sy është se ata njerëz kishin pasuri. Argument për këtë është fjala e tyre, "A të të paguajmë ty një detyrim (haraç) me qëllim që ti të mundesh të na ngresh një pengesë të pakalueshme mes nesh dhe atyre?". (Kehf, 18: 94). Ata kishin edhe fuqinë punëtore. Prandaj Dhul-Karnejni i urdhëroi ata duke u thënë: "Më ndihmoni me fuqi (punëtore)". (Kehf, 18: 95). Pastaj ai u tha atyre se ka ardhur koha për të ndërtuar pengesën, "Më sillni atëherë blloqe hekuri". (Kehf, 18: 96). Pastaj u tha: "Fryni (me shakull)", Pastaj

shtoi: "Më sillni bakër të shkrirë për ta derdhur mbi ta". (Kehf, 18: 96).

Por megjithatë ata kishin nevojë për më të rëndësishmet e shkaqeve të zhvillimit në mënyrë absolute. Gjithashtu atyre u nevojitej ndihma e Allahut për t'ua bërë të mundur atyre shkencën, teknologjinë, planifikimin dhe qartësinë e synimit dhe të objektivave.

Një lexim paraprak ndaj realitetit musliman sot dhe ndaj prapambetjes së tyre prej shkallës së civilizimit dhe ndaj realitetit të epërsisë së Perëndimit dhe epërsisë së tyre, do të na bënte t'i kuptonim thellë këto Ajete Kur'anore dhe do të na e bënin të qartë metodologjinë e Kur'anit për ngritjen e një zhvillimi të gjithanshëm, baza e të cilit është njeriu i aftë, i kualifikuar, aktiv dhe ndikues, edhe në qoftë se ai nuk do t'i posedonte lëndën dhe mjetet. Kjo është ajo që ne e lexojmë në krahasimin që Dhul-Karnejni e bëri dhe e nxori si përfundim midis "kapitalit të shprehur me fjalën haraç" dhe midis "epërsisë, mundësisë" dhe tha: "Ajo (fuqi, autoritet, pasuri) në të cilën më ka vendosur Zoti im është më e mirë". (Kehf, 18.95). Pavarësisht se disa komentatorë mbështetën mendimin se me fjalën "temkin" synohet pasuria ose lehtësia, por më e sakta është -dhe Allahu e di më së miri- se në adresimin e kuptimit të "temkin" është 'dhënia përparësi shpirtit të besimit, fuqisë së shkencës dhe epërsisë teknologjike'.

Atëherë, "njeriu" me të gjitha dimensionet e tij është boshti i zhvillimit në këto Ajete kur'anore.

ELEMENTET E ZHVILLIMIT NË TREGIMIN E SULEJMANIT A.S

Hazreti Sulejmani a.s arriti një zhvillim civilizues dhe një progres të tillë në të gjitha fushat sa që tek ai stad zhvillimi nuk ka arritur askush para tij dhe nuk do të arrijë askush pas tij. Ai zhvillim nuk u arrit ndryshe veçse me diturinë që Allahu ia dha atij, sa që dituria që iu dhurua ia kaloi edhe babait të tij. Allahu xh. sh tha: "Dhe Ne e bëmë Sulejmanin ta kuptojë çështjen dhe secilit prej tyre Ne i dhurua gjykimin e drejtë dhe dije". (El-Enbija, 21: 79). Gjithashtu Allahu tha: "Dhe Sulejmani trashëgoi Davudin. Ai tha: "O Njerëz! Na është mësuar gjuha e shpendëve dhe na është dhuruar gjithçka..." (En-Neml, 27:16).

Hazreti Sulejmani u shqua në fushat e shkencës dhe të njohjes, të tilla si: Shpejtësia, kuptimi i gjuhës së shpendëve, luftimi dhe beteja, artet e administrimit, dialogu, polemika, politika, falja, ndjesa, drejtësia dhe sundimi. Domethënë, ai u shqua në të gjitha gjërat që kanë potencialin të ndërtojnë një civilizim ideal, gjithëpërfshirës me aspekte integruese. Ai civilizim e tejkalon në progres realitetin e shteteve të zhvilluara në ditët e sotme. Sepse këto shtete kanë teknologji dhe mekanizmat, por atyre u mungojnë shpirti, falënderimet dhe moralet. Gjithashtu atyre u

mungojnë vlerat civilizuese jolëndore.

Perëndimi i ndërton themelet e zhvillimit vetëm mbi shkencën dhe mendon se “kush ka shkencën, ka në dorë marrjen e vendimit, dhe pikërisht kjo është e ardhmja. Dhe atij që i mungon njohja, i mungon fuqia për të marrë vendim”. Lidhur me mungesën e bazave të vlerave tek Perëndimi, mendimtari Muhatir Muhammed thotë: “Sipas vlerësimit tonë, asnjë shtet, cilido qoftë ai, nuk bëhet i përparuar edhe nëse është i pasur dhe ka teknologji, kur atij i mungojnë vlerat morale. Ka shoqëri të shumta perëndimore, për shembull, moralet e të cilave janë të prishura”.

Por, nga ana tjetër, është për të të ardhur keq që shteteve Islame u mungojnë të gjitha vlerat civilizuese, të cilat ngrenë lart dinjitetin e njeriut, dhe këto shtete janë kundra fesë së tyre dhe ecin në çudhëzim. Ato nuk kanë as teknologji, as shkencë dhe as nuk sundojnë në dimensionet e besimit e të moralit. Në të ardhmen atyre nuk do t’u vlejë kalimi i metodave të Perëndimit për zhvillim në kuptimin e mirëfilltë, por atyre u duhet të bëjnë dallim midis shpirtit dhe formës.

Ndoshta pyetja vërtet e ngatërruar dhe enigmatike është: “Çfarë e shtyu Sulejmanin a.s që t’i kërkonte Allahut një mbretërim që të mos e kishte askush pas tij? A nuk do të ishte kjo prej llojit të privimit të njerëzve prej mirëbërësisë së Allahut?! Fjala e Hazreti Sulejmanit, “Zoti im! Më fal mua dhe më dhuro mua mbretërim të atillë që të mos i shkojë (e të mos e ketë) asnjë pas meje. Vërtet që Ti, Ti je Dhuruesi i Vërtetë i begative pa kufi!” (Sad, 38: 35), që ai mbretërim të ishte i atillë sa që t’i tejkalonte limitet e tija njerëzore dhe të vinte brenda masave më të larta prej të Gjithëpushtetshmit Dhurues.

Ndoshta urtësia në këtë është se Allahu xh.sh e bëri majën më të lartë në fuqi, në progres e në mbretërim që të jetë maja falënderuese ndaj mirësive dhe jo mohuese ndaj Zotit dhe as mosmirënjohëse ndaj dhuratave dhe mirësive të Tij; sa që askush të mos thotë pas saj: “Përderisa unë jam më i miri, më i fuqishmi dhe më i pasuri, nuk shoh arsye që të falënderoj askënd tjetër dhe as të pranoj ndonjë zot”. Kurse Sulejmani a.s e arriti atë çfarë arriti duke qenë prej falënderuesve. Kështu, argumenti është provuar i qartë për të gjithë njerëzit pa përjashtim.

Si rrjedhojë, ne dalim me përfundimin se shkaku më i fuqishëm prej shkaqeve të zhvillimit të vërtetë është falënderimi. Allahu xh.sh tha lidhur me Familjen e Davudit a.s : “Punoni ju, O Familja e Davudit duke falënderuar!” Por pak nga robët e Mi janë falënderues” (Sebe’ë, 34: 13). Ashtu siç ishte edhe qëndrimi më i thjeshtë që e shtynte atë në dhënien e falënderimit, siç ndodhi tek tregimi me milingonat: “Derisa, kur mbërritën te lugina e milingonave, njëra nga milingonat tha: “O mizat e dheut! Hyni në shtëpitë tuaja, që të mos ju vënë nën këmbë Sulejmani dhe ushtritë e tij

pa e ndjerë”. Kështu ai (Sulejmani) qeshi i kënaqur nga fjala e saj dhe tha: “Zoti im! Më siguro mua fuqinë dhe aftësinë që të mund të jem falënderues për mirësitë e Tua të cilat Ti m’i ke dhuruar mua dhe prindërve të mi, dhe që të mund të punoj mirësi e drejtësi që të të kënaqin Ty”. (En-Neml, 27: 18-19).

Këto ishin disa shembuj prej elementeve të zhvillimit në metodologjinë Kur’anore. Ato të gjitha ngrihen mbi qënien e njeriut një bosht. Kur’ani është plot me shembuj të tjerë të cilët kërkojnë studime dhe analiza të thella. Prej atyre studimeve, për shembull, janë:

Planifikimi në tregimin e Jusufit a.s..

Përkushtimi i plotë dhe puna në tregimin e Musait a.s.. dhe

Investimi i kohës për të shqyrtuar fazat e biografisë së pastër të Pejgamberit tonë Muhammedit a.s.m.

NJË GRAFIK VLERËSUES RRETH ELEMENTEVE TË ZHVILLIMIT

Ndodhet një paradoks i ngatërruar i cili është:

-Qënia e “Njeriut Kur’anor” një njeri që i ka përmbushur të gjitha kërkesat e civilizimit; ndonëse ndonjëherë është dobësuar në aspektin material, veçse ama ai nuk ndikohet, por bazohet mbi aspektin më të rëndësishëm.

-“Njeriu musliman” sot, pavarësisht qënies së Kur’anit duke u recituar përpara tij, veçse ama ai është i ndryshëm prej të gjitha aspekteve duke mos përfutur prej Librit të tij për të ngritur një civilizim të dukshëm botëror.

-“Njeriu perëndimor” sot ka realizuar fitore të njëpasnjëshme në aspektin material dhe ngriti një civilizim botëror, por megjithatë atij i mungojnë moralet, vlerat dhe falënderimi.

Si rrjedhojë, njerëzimi sot duhet të mendojë për një zhvillim të gjithanshëm dhe për një civilizim të plotë, që të mos i ngjasojë krejtësisht modelit perëndimor, por duhet të ndërtohet mbi modelin Kur’anor duke përfutur prej asaj që prodhoi Perëndimi dhe duke i shtuar kësaj shpirtin dhe thellësinë.

Pavarësisht se këto grafike vlerësuese mund të rishikohen e korrigjohen, veçse ama ato shfaqin shkallën e përfutimit të Perëndimit prej elementeve materiale dhe shkencore për zhvillimin, dhe sqarojnë shkallën e mungesës së tij prej shkaqeve të moraleve dhe të besimit.

Kurse muslimanët sot po dobësohen në të gjitha aspektet. Megjithatë njeriu Kur’anor është një njeri integral në të gjitha fushat, i fuqishëm materialisht, i konsoliduar shpirtërisht dhe moralisht.

Ajo çfarë i mungon njerëzimit sot është ky ekuilibër i humbur midis materiale dhe shpirtit, midis gjërave të dynjasë dhe atyre të Ahiretit dhe midis të jashtmes dhe të brendshmes.

TERMI

Dhikr

Kuptimi i fjalës është 'shqiptimi i diçkaje, bërja e saj gati në mendje, një gjendje e shpirtit që i mundëson një personi të ruajë atë që ka fituar, duke e bërë atë që mbrohet dhe fitohet gati në mendje, duke kujtuar, përkujtuar'.

Në fakt, konceptet e 'Ajetit, Dhikrit, Kur'anit, Librit (Kitab)' kanë një marrëdhënie shumë të ngushtë me njëri-tjetrin. Është vërtet shumë e vështirë të shpjegosh secilën veç e veç; prandaj, disa përsëritje janë të pashmangshme.

Kur Zoti krijoi njeriun, Ai i mësoi atij 'emrat (esma)' . Emrat i referohen Emrave të Allahut dhe të gjitha qenieve dhe ngjarjeve që shfaqen në univers si shfaqje të këtyre Emrave. Me këto emra, Allahu e bëri njeriun më të lart ndaj të gjitha qenieve, i bëri engjëjt të bëjnë sexhde para tij dhe i dha gjithçka në univers në përdorim të tij. Shfaqjet e këtyre emrave në univers janë gjithashtu 'ajetet e Allahut'. (Me këto ajete, universi lexohet dhe Allahu arrihet.)

Njeriu u rebelua kundër Allahut duke përdorur lirinë e zgjedhjes që i ishte dhënë; Në një farë mënyre, kjo ishte për shkak të harresës së tij, njeriu është harrues nga natyra. Ky fakt shprehet në Kur'an si më poshtë:

Na, madje – edhe Ademiti i kemi shpallur më parë (në xhennet), e ai harroi, por nuk kemi gjetur tek ai vendim (për gabim të qëllimuar). (Taha: 115)

Aq sa personi harrues mori 'fjalë' nga Zoti i tij, në mënyrë që të mbante mend atë që kishte harruar, dhe filloi të mbante mend, domethënë, 'tedhekkur' me këto fjalë.

Allahu i ka dhënë njeriut mundësinë dhe aftësinë për të kujtuar atë që ka harruar.

Allahu Te'âlâ është Vetë Zoti, i cili bën me shenjë për Vetën në të gjitha ngjarjet që ndodhin brenda dhe jashtë nesh dhe në univers. Në thellësitë e shpirtave tanë, para së gjithash, ekziston një pohim absolut i thelbit të Zotit; Prandaj, besimi në Allahun është i natyrshëm dhe është kreu i gjithçkaje. (Shkenca e Perëndimit, e cila ndoqi një metodë induktive, filloi duke refuzuar këtë natyrë dhe besim, dhe për këtë arsye, larg arritjes të së vërtetës, ajo ka shkaktuar telashe të papara për njerëzimin, si dhe përfitime, me gjërat që ka zbuluar në emër të shkencës. Megjithatë, në Islam, gjithçka, përfshirë diturinë, del nga një e vërtetë e qëndrueshme dhe e pandryshueshme, e vërteta e Allahut, parim mbi të cilën edhe bazohet dija islame.)

Në ekzistencën e njeriut, kjo e vërtetë e pamohueshme ekziston si thelb. Por njeriu gjithnjë e më shumë po përpiket ta mbulojë këtë fakt me ndikime të ndryshme; ai mbyll shqisat e tij, mendja dhe mendimi i tij vdesin, zemra e tij errësohet dhe ai bie në harresë dhe gaflet (pakujdesi) të plotë. Një person në këtë situatë ka nevojë për prova dhe shenja që do t'i kujtojnë këtë të vërtetë të caktuar. Universi është plot me këto dëshmi dhe shenja. Meqenëse Kur'ani na kujton këto dëshmi dhe shenja, ai quhet edhe edh-Dhikr. Kjo do të thotë se Dhikri është para së gjithash Kur'an, në një aspekt tjetër është vetë universi, Libri kryesor. Është Levhi Mahfudh (Pllaka

e Ruajtur). Në fakt, në një hadith, thuhet se "Nuk ka pasur asgjë përveç Allahut, Arshi i Tij ishte mbi ujë dhe Ai shkroi gjithçka në Dhikr, dhe pastaj krijoi shtatë qiejt"; ky hadith në një mënyrë tjetër thuhet, "Ai ka shkruar në Levhi Mahfudh dhikrin e çdo gjëje." Të dyja transmetimet shpjegojnë njëra-tjetrën; në transmetimin e parë, Levhi Mahfudh referohet si dhikër, ndërsa në të dytin, dhikri përdoret në kuptimin e "gjërave që përbëjnë Levhi Mahfudhin", nuk ka asnjë ndryshim midis tyre. Në këtë kuptim, "Na, me të vërtetë, kemi shpallë Kur'anin dhe, Na, me të vërtetë, do ta ruajmë atë". Dhikri i përmendur në ajetin e sures Hixhr 9 përfshin Kur'anin, i cili është i gjithë Levhi Mahfudh, ose si Kur'ani ashtu edhe Suneti.

Ekziston një marrëdhënie e ndërlikuar midis shpirtit dhe trupit në vetën e njeriut. Ato janë shenjat që vijnë nga shqisat, të cilat janë dritaret që hapen nga jashtë, të asaj që njerëzit shohin, dëgjojnë, prekin, shijojnë dhe nuhasin. Këto shenja tregojnë një kuptim në fazën e parë. Pastaj, shpirti e kupton këtë kuptim në tërësi. Ky kuptim ndodh në zemër, dhe si rezultat, ka disa ndikime në trup. Për shembull, një shije e thartë sjellë një verbim, nxehtësia shkakton lodhje, lajmet e këqija krijojnë një tronditje. Po kështu, disa gjëra që ndodhin në trup ndikojnë edhe në shpirt. Në mënyrë të ngjashme, kur një person bën dhikër me gjuhën e tij, kujton Allahun ose ajetet e Tij, ose kujton origjinën nga Bota e Shpirtave, thotë 'Allah'ose 'La i lahe il-la Allah, subhana-Allah, ve'l-hamdulillah, ve la i lehe il-la Allahu ekber' përballë shenjave në univers, shfaqet një vepër imagjinatë. Sidomos, siç thuhet në një hadith, "kur gjuha e kujton Allahun në atë masë sa të tjerët thonë se është e çmendur", dhe me urdhër të Kur'anit "kur dhikri i Allahut rritet vazhdimisht", puna që shfaqet në imagjinatë krijon një dritë në zemër; Pastaj kjo dritë reflektohet nga zemra në gjuhë, nga gjuha në imagjinatë, nga imagjinata në mendje, dhe ato përforcojnë dhe forcojnë njëra -tjetrën si pasqyra. Si rezultat i kësaj, zemra fillon

të bëj dhikër dhe besimi shfaqet plotësisht në zemër. Dhikri i zemrës nuk ka fund. Dritat e formuara nga ky dhikër shtrihen në realitetet dhe origjinën në Botën e Shpirtave, që njerëzit e kanë harruar; kënaqësia që jep e përshpejton dhikrin edhe më shumë. Së fundi, ai sheh të vërtetën e gjërave dhe arrin dije të besueshme dhe të pagabueshme. Zotëria i dy botrave Muhammedi a.s ka thënë: "Unë kam një kohë me Allahun në të cilën as engjëjt më të mëdhenj dhe as një peygamber i dërguar nuk mund të më afrohen". Dhikri i zemrës çon natyrshëm në dhikrin e trupit. Çdo pjesë e trupit fillon të bëj dhikër, domethënë të veprojë në drejtim të Kur'anit. Kështu, njeriu kalon nga të qenit harrues në të qenit afër, domethënë, ai fiton vendin e tij në krye të hierarkisë së qenieve; Ngrihet nga vendi më i ulët për tek më i larti.

Në Kuran, dhikri ndonjëherë përdoret në kuptimin e kundërt të harrimit dhe pakujdesisë:

"Dhe në vete përmende Zotin tënd, me përlujë dhe drojë – jo me zë të lartë, në mëngjes dhe mbrëmje, dhe mos u bën i pakujdesshëm." (A'raf: 205)

"Mos dëgjo atë – zemrën e të cilit ia kemi lënë të zbrazët nga të përmendurit Neve..." (Kehf: 28)

"Vetëm djalli më ka shpie në harresë..." (Kehf: 63)

Njeriu arrin lumturinë dhe përbushjen jo duke kënaqur dëshirat e tij materiale dhe sensuale, por duke kujtuar të Vërtetën që ka harruar, duke arritur këtë të Vërtetë dhe duke kujtuar vazhdimisht Allahun për ta arritur atë: "E, me të vërtetë, kur të përmendet Perëndia, zemrat qetësohen!" (R'ad: 28)

Jeta e njerëzve duhet të jetë një dhikër i plotë; Sepse, shoku i atij që lë dhikrin është vetëm djalli: "Kush shmanget nga Këshilla (Kur'ani) e Mëshiruesit të Githëmbarshtëm, Na do t'ia ngarkojmë djallin dhe ai do t'i bëhet shok atij." (Zukhruf: 36)

Dhikri përdoret ndonjëherë në Kur'an në kuptimin e lutjes. Aq sa lutja është një formë, një pjesë e dhikrit; dhikri është më

gjithëpërfshirës se namazi, është më i madh: "Namazi, me të vërtetë, të largon (pengon) nga korrupcioni dhe nga çdo vepër e shëmtuar. E, të përmendurit e Perëndisë është më e madhja (lutje)!" (Ankebut: 45)

Pejgamberi i përshkroi takimet e dhikrit si 'Kopshte të Xhennetit'. Këtu, dhikri përfshin mendime fetare dhe shkencore të bëra në emër të Allahut.

Imam Xhafer es-Sadik tha: "Nuk ka asgjë pa kufi, përveç dhikrit. Allahu ka bërë vepra të obliguara, përmbushja e të cilave është fundi i tyre; agjërimi në Ramazan është fundi i këtij muaji; fundi i farzit të haxhit është pelegrinazhi. Megjithatë, Allahu nuk është i kënaqur me dhikrin e pakët, kjo sepse nuk ka fund, ndaj dhe thotë: "O besimtarë, përmendni shpesh Perëndinë, dhe lavdëroni Atë në mëngjes dhe në mbrëmje!" (Ahzab: 41, 42)

Bereqeti i shtëpisë në të cilën lexohet Kur'ani dhe përmendet shumë Allahu rritet, engjëjt janë të pranishëm atje, djajtë nuk mund të strehohen.

Aliu r.a. gjithashtu thotë: "Kush e kujton Allahun në fshehtësi, Allahu e kujton atë hapur; vërtetë munafikët e përmendin Allahun hapur, por kur janë vetëm nuk e përmendin. Allahu ka thënë kështu: 'Me të vërtetë, hipokritët përpiqen ta mashtrojnë Perëndinë... duke u paraqitur karshi botës (që janë besimtarë), e Perëndinë e përmendin pak herë.'" (Nisa: 142)

Në dritën e këtij shpjegimi të përgjithshëm, përmendet në Kuran se "bëri dhikër (dhejera), bëni dhikër, bëj dhikër (kujto, jep këshillë) le të bëjnë dhikër (në disa raste vjen në kuptimin 'të marrin shembull'), dhikër (të kujtosh), dhikër (kujtoni, këshillon), dhikër (ndonjëherë, në kuptimin "merrni një mësim"), këto forma dhe të ngjashme mund të kuptohen më lehtë dhe nuk ka nevojë të ndalemi në to veç e veç. Ndërsa në rastin e ajetit: "Mos e hani atë, që kur është therrë nuk është përmendur emri i Perëndisë" (En'am: 121) kur folja 'dhe-ke-ra' shoqërohet me lidhje gjinore merr kuptimin 'me përmend, me përkujtu'.

Përktheu: Haki Sahitaj

A jemi bletë, bilbila apo hardhuca?!

Në shikim të parë ky titull duket jo i zakonit dhe paksa i çuditshëm. Në këtë mënxiti rasti i mikut të Allahut, Ibrahimit a.s. i cili për shkak të besimit të tij nga pabesimtarët u hudh në zjarr.

Ibrahimi a.s. para se gjithash ishte njeri i cili me fenë dhe mirësinë e tij u ngrit në nivelin që e xhelozuan edhe melekët. Në anën tjetër njeriu me veprat dhe ligësitë e tij mund të bie në nivelin që nuk u gjason as kafshëve.

Shembulli i Ibrahimit a.s. nuk është vetëm një tregim bosh që ka ndodhur mijëra vjet më parë. Përkundrazi, ky është një mesazh i përhershëm për të gjitha gjeneratat deri në ditën e Gjykimit. Ibrahim a.s. ishte simbol i besimit, mirësisë, i dërguar për të paralajmëruar njerëzit dhe për t'i udhëzuar të humburit. Ndërsa populli i tij vërtet ishte zhytur në gjitha llojet e mëkateve.

Ibrahimi a.s. e dinte se është në rrugën e vërtetë dhe nuk u ndal dhe as nuk humbi shpresën. Por shpresën e kishte humbur populli i tij i prishur i cili vendosi që në fund ta hudh në zjarr të madh.

Natyrisht nga fuqia dhe mëshira e Tij, Allahu e bëri që zjarri mos ta djeg Ibrahim a.s., përkundrazi u bë i ftohtë dhe shpëtimtar. Por sipas tregimeve të shumta ky rast ka shënuar edhe sjelljen e disa kafshëve. Kështu, bleta në gojën e saj ka bartur pika uji duke u përpjekur të ndihmojë në shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit të Ibrahimit a.s. Ta shuajë zjarrin ka ndihmuar edhe bilbili. Por ishte një kafshë e cila ishte në anën e pabesimtarëve e kjo ishte hardhuca e cila i frynte zjarrit duke u përpjekur që ta përhap më shumë.

Përse i përmendëm këto?

Thamë se tregimet e Kuranit nuk janë vetëm rrëfime boshe, por mësim deri në ditën e Gjykimit. Sulmi mbi Ibrahim a.s. është sulm mbi fenë, ndërsa hudhja e tij në zjarr është përpjekje që përgjithmonë të shuhet drita e Allahut. Këso sulme dhe përpjekje ka pasur dhe ka gjithmonë. Jemi dëshmitarë edhe sot përpjekjeve që të ulet feja dhe çdo gjë që lidhet me të, e në anën tjetër çdo gjë e shëmtuar paraqitet e bukur.

Sulmi dhe nënçmimi i fesë sonë kërkon edhe reaksionin tonë. Në këtë rast mundemi me qenë sikurse bletët dhe bilbilat të cilët kanë dhënë një kontribut

modest gati minimal në shuarjen e zjarrit dhe në këtë mënyrë vetit i siguruan pozitë të veçantë deri në ditën e Gjykimit. Pak gjëra mund të maten me zërin e këndshëm të bilbilit, ndërsa për bletën flet një kaptinë e veçantë e Kuranit. Bleta është e inspiruar nga Allahu dhe nga barku i saj del mjalti i cili është ushqim dhe ilaç. Ndërsa hardhuca është e urrejtur deri në ditën e Gjykimit.

Pra, bleta dhe bilbili kanë qenë të vetëdijshëm se nuk mund ta shuajnë tërë atë zjarr në të cilin ishte hudhur Ibrahim a.s. dhe se munda i tyre ishte i vocërr, gati i pavërejtur. Por nuk deshën të ngecin anash dhe në mënyrë pasive të vëzhgojnë shkatërrimin e të vërtetës. Në këtë mënyrë na dhanë mesazh të madh, leksion që vazhdimisht duhet ta kemi ndërmend. Nuk duhet të jemi vëzhgues pasiv i së keqes dhe nuk duhet të arsyetohemi me atë se nuk mund të ndryshojmë asgjë.

Përkundrazi, duhet të japim kontributin tonë në promovimin e së mirës dhe largimin e së keqes, qoftë edhe minimalisht. Në fund edhe Pejgamberi ynë s.a.v.s. na këshillon që të jemi sikurse bleta, ngase ajo ushqehet me atë që është e bukur dhe pastër dhe pas vetit lë atë që është e këndshme dhe e pastër.

Mjerisht ka prej nesh që i gjasojnë hardhucës dhe çdo përpjekje të pabesimtarit që të na përul neve dhe fenë tonë e presim duke e përkrahur, e mos dhashtë Zoti edhe duke e ndihmuar.

Me çfarë tjetër ta krahasojmë atë që promovon të keqen, ndan xhematin, prish bukuritë e fqinjësisë, shkruan, debaton, duke njollosur fenë dhe komunitetin, pos me hardhucën e cila i fryu zjarrit ku ishte hudhur Ibrahim a.s.

Por, zjarri nuk e djeg Ibrahim a.s. edhe pse keqbërësit këtë shumë e dëshironin. Jam i sigurt që me ndihmën e Allahut as zjarri i sprovave dhe kurthave me të cilat ne si besimtarë vazhdimisht jemi të ekspozuar, nuk do të na dëmtojë as neve e as fenë tonë.

Për këtë, të meditojmë për rrëfimet e Kuranit dhe të jemi gjithmonë në anën e së mirës, sepse e mira gjithmonë triumfon.

Lutemi Allahut xh.sh. të na bëjë prej atyre që urdhërojnë për të mirën dhe largojnë nga e keqja dhe prej atyre që Ai është i kënaqur. AMIN!



DREJT Mekës

Ka shekuj që ke hapur krahë besimi
Meka jonë e Madhëruar.
Tokë e çuditshme,
Me gurë e rërë e male,
Po me ngrohtësinë më të madhe
njerëzore
Prej shekujsh vijmë drejt teje,
Të kapluar nga lumturia
Nga dallga e fuqishme e adhurimit,
Nga vende
ku kufijtë kthehen në lodra
Vijmë drejt teje
ku çdo fjalë merr nota vëllazërore.
Në të majtë – i panjohur
Në të djathtë – i panjohur
Prapa – i panjohur
Para – i panjohur.
Jo, asnjë nuk njoh në këtë oqean
njerëzor.
Po jemi të gjithë
Vëllezër të një besimi të pasosur
Përkulur para vullnetit hyjnor.
Ka shekuj që vijmë drejt teje, o Mekë
Tek ti, o Qabe,
Tek begatia jote, o vendshpallja e
Kur'anit
Tek ti, o mal i Arafatit
Tek freskia jote, o ujë i Zemzemit
Fluturojmë ngutshëm me erën
Më shpejt se ne vrapon besimi,
Ezani, adhurimi,
Shehadeti, mëshira
Falënderimi për Allah
Na largon natën e Xhehenemit.
këtu është larg thirrja e fisit.
Është larg
thirrja e një kombi të vogël apo të
madh.
Është larg
Thirrja e një kontinenti të vjetër apo të ri.
Ti, vetë Mekë,
je kontinenti pa kufi i Islamit
Mirë se të gjejmë!
E dimë,
Zemra jote është e hapur për të gjithë.



Familja

SHKOLLA MË E MIRË PËR EDUKIMIN E NJERIUT

Mënyra me të cilën familja kryen funksionin e saj përcakton një pjesë të madhe të shanseve të të rinjve për t'ia dalë mbanë në rrugën e tyre drejt autonomisë sociale. Si pasojë, para se të kenë një problem personal, të rinjtë në vështirësi kanë shpesh një problem familjar; para se të ndihen keq vetë, ata ndihen keq në familje.

Për mirë apo për keq secili prej nesh është produkt i familjes së tij të origjinës, si në formim fizik, ashtu edhe në atë psikologjik, social dhe moral. Prindërit tanë kanë ushtruar te ne një ndikim fizik, psikologjik dhe social. Trupi ynë, si për nga funksionimi, ashtu edhe nga pamja e jashtme, varet shumë nga modelet e marrëdhënieve që kemi mësuar nga kontaktet me prindërit tanë.

Gjërat që ne i konsiderojmë të rëndësishme në jetë (vlerat), qëllimet që ne ndjekim, arsyet që ne mbrojmë, miqtë që ne kemi, mënyra jonë për të zënë një vend në shoqëri, janë në funksion të vlerave të mësuara në mjedisin familjar. Marrëdhënia prind-fëmijë është një përbërës kryesor në zhvillimin e të rinjve. Megjithatë familjet s'janë të gjitha të njëjta. Portretet e familjeve janë të shumëllojshme.

Familja është strukturë sociale në të cilën jetojnë njerëz që kanë jo vetëm lidhje gjaku midis tyre, por kanë pozicione dhe luajnë role sociale, të cilat nuk bëhen arbitrarisht apo nuk caktohen me zgjedhje. Në çdo familje ka patjetër një hierarki biologjike dhe role sociale të determinuara, prandaj në të ka ca rregulla të sjelljes, dhe doemos edhe një masë humane të hierarkisë moshore.

Familja shqiptare ndërkaq, ka ca vlera konstante të traditës, që nuk janë lëkundur as nga moderniteti, as nga liberalizimi i jetës demokratike të shoqërisë shqiptare. Këto role dhe pozicione janë të kristalizuara, që në fazën e formimit dhe që vazhdojnë organikisht dhe normalisht edhe në rrugën e konsolidimit të familjes.

Ne duhet të bindemi për disa ndryshime me rëndësi që kanë ndodhur në tipologjinë e familjes moderne shqiptare, në formatin e saj edukativ. Familja nuk është një institucion social që ka jo vetëm funksione biologjike, por së pari sociale dhe edukative. Ajo është organizata e shoqërisë që ka më shumë mundësi të funksionojë si strukturë sociale me unitet edukativ midis pjesëtarëve të saj, në radhë të parë midis prindërve dhe fëmijëve të tyre. Mungesa e unitetit edukativ në familje ka pasoja fatale në deformimin e personalitetit të fëmijëve të saj. Ky është kushti që siguron atmosferën e një respekti të ndërsjellë në familje, si parakusht për edukimin e fëmijëve. Nuk edukohet fëmija nëse familja nuk bëhet vërtet një "skuadër" që funksionon dhe ndërtohet e bazuar në parime edukative unike, njerëzore të përbashkëta. Vetëm kjo atmosferë krijon kushte që prindi të ketë një ndikim edukativ personal të frytshëm dhe të qëndrueshëm mbi fëmijët e vet. Por që të realizohet ky mision i madh duhet shumë përgjegjësi, aftësi, takt edukativ dhe kurajë qytetare. Kjo do të thotë se duhet së pari që prindërit të kuptojnë dhe të pranojnë se kanë ndryshuar parimet e organizimit, funksionimit dhe marrëdhëniet e familjes me fëmijët,

ka ndryshuar paradigma tradicionale e "ndërvarësisë edukative" etj. Nëse nuk kuptojnë realitetet familjare të ndryshuara, ata nuk mund dhe nuk do të jenë në gjendje që të zgjidhin problemet që kanë fëmijët e tyre me veten, familjen dhe procesin e formimit të tyre edukativ, nuk do të gjejmë në të njëjtën kohë shkaqet pse ata si prindër janë të irrituar, pa takt komunikimi, me kompostim agresiv. Thelbi i suksesit apo i dështimit në punën edukative në familje, është i lidhur ngushtë me mënyrën se si prindërit i shikojnë problemet që kanë fëmijët me veten dhe moshën e tyre, por që në të njëjtën kohë, i kanë edhe ata në marrëdhëniet që ndërtojmë me fëmijët. Nëse fëmijët nuk i dëgjojnë, nuk ubesojnë, veprojnë në kundërshtim me porositë e tyre edukative, kjo nuk është në çdo rast tregues i natyrës së tyre kontradiktore. Së pari, kjo situatë komunikimi neurotik dhe skepticizmi edukativ është tregues sintetik i faktit që në familje mungon besimi i ndërsjellë, marrëdhënia e thellë reciproke midis prindërve dhe fëmijëve. Edukimi i fëmijëve dhe adoleshentëve në kohën tonë nuk bëhet me irritime prindërore anti-edukative, por duke ndryshuar dhe përmirësuar raportet, ndërveprimet, marrëdhëniet prind-fëmijë. Sa herë që fëmijët kanë probleme edukative, aq më shumë kjo kërkon që prindërit të merren me kujdes, të komunikojnë dhe të ndërveprojnë me ta. Shqetësimet edukative të tyre janë sinjale të sigurta se prindërit nuk janë marrë sa duhet që ata të dalin nga ngërçet edukative që kanë me veten, prindërit, mësuesit apo të tjerët.

Kjo do të thotë që puna edukative e prindërve nuk është vetëm ligjërime dhe urdhra që nuk kanë vlerë dhe ndikim, por një punë vepruese, komunikuese dhe transformuese, që sjell më shumë lidhje besimi dhe dashurie midis tyre. Kjo krijon atë situatë edukative, kur fëmija e ndjen veten të vlerësuar nga kujdesi i singertë edukativ i prindërve.

Koha moderne kërkon modele të reja të vlerësimit të problemeve që kanë fëmijët, shqyrtim me kujdes dhe tolerancë të virulencave edukative të kohës, që ata i manifestojnë bujshëm në jetën e tyre.

Të rinjtë mund të edukohen në familje, por vetëm atëherë kur fëmijët dhe prindërit e duan dhe e respektojnë njëri-tjetrin. Në familjen që bëhet sundues detyrimi me forcë, minimalisht edukimi mungon. Në këtë rast vlera edukative e familjes shqiptare do të vazhdojë të jetë në rënie të lirë, duke e bërë atë thjesht një mjedis familjar biologjik, por pa funksionin dhe rolin e rëndësishëm edukativ.

Ndërmjet kompetencave prindërore më të rëndësishme, konstatohet ndjeshmëria ndaj fëmijës. Me ndjeshmëri kuptojmë aftësinë për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës, të treguarit kujdes ndaj pyetjeve dhe kërkesave të tij, të qenët i hapur ndaj projekteve të tij. Fëmija që zhvillohet në një botë që për të është

e ndjeshme, zhvillon një ndjenjë besimi bazë, që do të thotë: një ndjenjë besimi për të ndikuar në atë që do t'i ndodhë.

Një fëmijë që flet, por që nuk merr përgjigje, mëson se nuk ia vlen të flasësh në këtë rast. Një fëmijë që qan dhe të cilit askush nuk i përgjigjet, mëson të mos qajë më sepse e kupton se e qara s'të jep asgjë.

Përkujdesja aktive pranë fëmijës apo adoleshentit është një tjetër aftësi prindërore shumë e rëndësishme. Në të vërtetë, roli i modelit, i mbikëqyrësit, i pilotit të zhvillimit nuk përputhet me pasivitetin apo me mungesën e përkujdesjes. Për të ushtruar këtë ndikim, për të aktualizuar rolet dhe lidhjet afektive, prindi duhet të qëndrojë pranë fëmijës, të përfshihet në mënyrë aktive në botën e tij.

Një pjesë e mirë e të rinjve që kanë probleme psiko-sociale, kanë një mungesë përkujdesjeje apo pranie të prindërve të tyre. Për të luajtur mirë rolin e prindit duhet t'i qëndrosh pranë fëmijës, të përjetosh gjërat me të; ndryshimet bëhen aq shpejt në jetën e fëmijës sa është shumë e vështirë për prindin të ruhet realiteti i fëmijës pa qëndruar pranë tij.

Mbështetje, vazhdimësi dhe respekt, ja tre kategoritë e mëdha të nevojave që shfaqin të rinjtë në lidhje me familjet e tyre dhe për më tepër në lidhje me shoqërinë e zgjeruar.

ISMAIL MAÇI

(1885-1960)

VEPRIMTAR I SHQUAR TIRANAS

Ismaili lindi më 24 maj 1885 në një familje të vjetër tiranase, e ardhur dy shekuj më parë nga Shupali dhe e njohur për qëndrimin që mbajti gjatë anarkisë feudale në shekujt XVII-XIX përkrah familjes Bargjini (Tirana). Gjyshi i Ismailit, Haxhi Musa Maçi, në fillim të shekullit XIX e shpëtoi nga kundërshtarët toptanas djalin e vetëm të Bargjinëve, në moshë të vogël, Haxhi Et'hëm Beun dhe nuk iu nda derisa e rriti dhe e edukoi jashtë shtetit duke e bërë alim (të ditur) me famë. Et'hëm beu është ndërtuesi i xhamisë që sot mban emrin e tij. Ai hapi një medrese në Tiranë dhe shkroi 4 divane në gjuhën shqipe me alfabet arab.

Po në familjen e Haxhi Et'hëm Beut, te trashëgimtari i tij Qazim bej Tirana, në Durrës qëndroi Ismaili për disa vjet, derisa mbaroi shkollën ruzhdije (të mesme turke).

Ishte koha kur ndryshimet në jetën shoqërore po bënin realitet formimin e bashkësisë kombëtare ku rolin vendimtar e luanin bartësit më autentikë të jetës

kombëtare - inteligjenca e mbështetur fort në parimet e moralit islam, që në Tiranë ishte bërë qysh me themelimin e qytetit, sundues në tërë shoqërinë.

Një intelektual i tillë nisi të bëhej edhe Ismaili. Ai ishte ndër veprimtarët e shoqërisë së krijuar për lirinë dhe shkollën shqipe qysh në vitin 1896 e që funksiononte ilegalisht për të sjellë në Tiranë dhe në rrethet e saj libra dhe gazeta shqipe të botuara në kolonitë shqiptare të Rumanisë, Bullgarisë, etj.

Edhe në mbrojtjen e pavarësisë e të çështjes kombëtare në vitet 1912-1914, Ismaili qëndroi krahas shqiptarëve në luftë me osmanët që e arrestuan dhe e mbajtën në burg së bashku me 125 shokë të tij patriotë tiranase dhe me 30 të tjerë jabanxhi (jo tiranase, por me banim në Tiranë).

Tirana, në kushtet e reja që u krijuan me mbarimin e Luftës së Parë Botërore, mbeti përsëri një qendër nga më të rëndësishme në Shqipëri. Popullsia e Tiranës, sikurse i gjithë

populli ynë, mbante një qëndrim të theksuar patriotik. Në këtë kohë në Tiranë qenë grumbulluar e kryenin veprimtari të gjatë edhe patriotë të njohur jabanxhi si Hasan Prishtina, Sotir Peçi dhe shumë imigrantë të tjerë kosovarë e dibranë si: Vehbi Dibra (Agolli), etj., kështu që në Tiranë lëvizja patriotike po dilte nga kuadri i saj lokal.

Në Tiranë u vendos qeveria, u bë kryeqyteti i shtetit të ri shqiptar më 1920. Në vitin 1923, Ismaili që ndër bashkëpunëtorët më të afërt të Vehbi Dibrës, në organizimin e Komunitetit Musliman Shqiptar ku, përveç të tjerave, i vunë organizmat fetare të masës dërrmuese të popullsisë në vendin tonë myslimanëve - mbi bazat kombëtare administrativisht e organizativisht jashtë ndikimeve politike të huaja, të dëmshme dhe antipatriotike. Me këto vendime u vunë në jetë idealet e rilindësve tanë për sigurimin e bashkimit dhe vëllazërimit kombëtar të mbarë shqiptarëve pa dallim besimi.

Fill pas këtij kongresi historik nisi puna për t'i vënë në jetë vendimet e tij e filloi botimi i revistës së parë të Komunitetit Mysliman me emrin kuptimplotë "Zani i Naltë". Ismail Maçi u ngarkua me drejtimin e saj, detyrë që e kreu me devotshmëri prej vitit 1923 deri në vitin 1926.

Qysh në programin e revistës, botuar në titullin "Parathanë e qëllim" në faqen 3-6 të numrit 1, në tetor 1923, thuhet: "Asht për t'u vajtuar për të vërtetë gjendja e sotme, në çdo pikëpamje e Komunitetit Muhamedan në Shqipëri... Na të përkoshmes, pra, do ta kemi për qëllim me u munduem e me i ndaluem hovin këtij shkatërrimi që shihet në elementin mysliman shqiptar, tue i dhanun këtij shkas për të bërë ma të kërthnesët kah përparimi e qytetnimi kohotar...", përcaktohen objektivat e saj e të Komunitetit Musliman (Xhemati Islamije) për 1) Me bashkuem... popullin Mysliman Shqiptar. 2) Me përmirsuem gjendjen... e institucioneve Myslimane... 3) Me ia zbuluem popullit Mysliman shqiptar të vërtetat e besimit... 4) Me plotsuem vllazninë ndërmjet të gjithë elementeve në Shqipëri. 5) ... me forcuem edhe themelet e një politikës së shëndoshë e thjesht kombëtare në shtetin tonë".

I tërë ky numër përfshin drejtimet e revistës që "merret me filozofi, moral, literaturë kombëtare". Kështu, në faqet 7-9, në poezinë kushtuar Muhamedit a.s., në strofën e parafundit bëhet lutje: "Sa t'jetë jeta mbretëroftë / Dija, përparimi, atdheu lulëzoftë".

Në faqet 10-13 përshkruhet me hollësi falja "e para xhuma e xhemati islamijes" në Xhaminë e Vjetër të Tiranës ku "Zani i Myftiut

(Vehbi Dibra - Agolli) e gjuha amtare me gjithë forcën e saj filloi të përndajë shpresë prej minberit", "Myftiu duke folur për udhrat e Perëndisë...". Pika e parë janë urdhnat që i përkasin kësaj jete: prej ktyne ma e para asht dashtunia e Atdheut".

Në faqen 14-16, nën titullin "Pika e moralit e filozofia", duke folur për injorancën, përmend gjëra me aq rëndësi edhe për sot: "Sheh me të keq shokun e vet, larg të dijshtmit... idhnohet shpejt, flet kot, i jep dhanti të pameritueshtmit, mbulon mështefësit, i beson kujtdo, nuk din të dallojë mikun prej armikut".

Ndërsa në faqen 16-21 artikulli "Me çfarë mund të rrojë myslimani i sotëm?" mbyllet me këshillën aq të vlefshme për kohën: "Religjioni na urdhëron nderimin e femnave, që do të përgatisin një botë të re në Shqipëri".

Duke punuar natë e ditë për të bërë realitet këtë program madhështor, kryesia e Komunitetit Mysliman arriti ta ngrejë edhe shpirtin mysliman shqiptar në nivelin e duhur e të zhvillojë një varg aktivitetesh me rëndësi kombëtare duke e bërë qytetarin mysliman luftëtar të së resë përparimtare kudo në Shqipëri. Revista "Zani i Naltë" qëndroi gjithmonë në lartësinë e duhur si zëdhënës i kësaj kryesie.

Prandaj, fillimisht është çmuar e çmohet roli i kësaj reviste në edukimin e masave myslimane në mbarë Shqipërinë krah për krah me institucionin kryesor - Medresen e lartë, që u bë farkëtuesja e kuadrit të përhapjes së mësimit islam në çdo skaj të Shqipërisë.

Gjatë viteve 1930-46, zyra avokatore në Pazarin e Vjetër, ku ai punonte si shkruer publik, ka qenë qendër e klerikëve myslimanë tiranas. Aty gjendeshin ndër të tjerë Hafiz Ibrahim Dalliu, Sulejman Kadiu, Haxhi Mahmud Dashi, por edhe Hafiz Ali Korça, Hafiz Ismet Dibra e të tjerë.

Në vitet e demokracisë, në vitin 1995, për punë të paprerë në shërbim të popullit, u dekorua me medaljen "Për veprimtari patriotike" me motivacionin: "Ka kontribuar në luftën për çlirimin kombëtar e pavarësinë e vendit. Është shquar në përhapjen e arsimit shqip".

Gjatë kohës që jetoi, Ismail Maçi punoi me devotshmëri, i pajisur me parimet e larta të fesë islame. Populli i Tiranës e zgjodhi disa herë me radhë përfaqësues të vetin në Këshillin Bashkiak dhe, për çdo zgjedhje të deputetëve, si zgjedhës të dytë. Materialet e arkivit të Bashkisë ruajnë të dhëna se sa me vendosmëri Ismail Maçi mbronte interesat e popullit të thjeshtë.

Ndërroi jetë më 10 janar 1960 dhe u varros me nderime nga populli e me shërbimet fetare të zakonshme të xhematit.

Xhamia e Nazareshës

ELBASAN

Xhamia e Nazareshës në Elbasan, bën pjesë në "fondin" e xhamive më të hershme të vendit tonë. Mendohet të jetë ndërtuar në vitin 1599. E para faltore monumentale në të cilën më 7 dhjetor 1990 u organizua ceremonia e parë për rikthimin e besimit fetar, gjë e cila i parapriu edhe protestave të mëvonshme për rrëzimin e diktaturës komuniste. Kjo tregon qartë se rebelimi apo " kryengritja" e parë në Shqipëri ndaj komunizmit erdhi pikërisht nga ky objekt kulturi. Sipas dokumenteve në arkivën e Myftinisë së Elbasanit, nismëtarët e kësaj lëvizje, ata të cilët nuk mund të heshtnin më, ishin: imam Kajo Biçaku, Agim Denizi, Hyqmet Dauti, Adem Perlepi, Besnik Kuburja si dhe Eduart Haxhihyseni. Kjo xhami e vogël, nëpërmjet teknikës së arkitekturës, ndërlihd traditën e artit të ndërtimit të periudhës pararendëse bizantine me atë osmane.

Arkitektura e saj është e veçantë në llojin e vet. Nga jashtë ka formën e një shumëkëndëshi e ndërtuar në gur, me një kupolë të madhe në mes si dhe me një minare të gjerë, gjysma e së cilës është shembur.

Në brendësi ruhet në formën origjinale të sallës së faljes. Salla me përmasa kuadrato ndriçohet nga pesë dritare të vendosura në tre radhë. Dritaret e poshtme janë dekoruar nga korniza prej gurësh të gdhendur. Akustika është mbresëlënëse, jehona e kupolës shpërndan në mënyrë të barabartë zërin në të gjithë sallën.

Pamja ballore e xhamisë paraprihet nga një portik i mbuluar me çati prej druri, përmes së cilit kalohet në sallën qendrore, tipike e xhamive të hershme.

Regjimi komunist nuk mundi ta shembë atë, siç bëri me shumë faltore të tjera në të gjithë vendin. Dëmtimet që ajo ka pësuar si shembja e minares si dhe plasaritja e mureve nga jashtë janë të hershme, në kohën e luftimeve italo – greke që më së shumti u zhvilluan në Shqipëri. Në këtë periudhë ajo është goditur aksidentalisht nga një predhë, duke i shkaktuar dëmet që shihen edhe sot.

Kjo xhami me vlera të rëndësishme historike kulturore e monumentale, e cila mban meritën e rikthimit të besimit fetar në vend, vazhdon të ruhet me fanatizëm dhe të funksionojë normalisht edhe sot në shekullin e ri.

Xhamia është shpallur monument kulture, dhe së fundmi është restauruar nga TIKa duke u rikthyer në identitet.

Xhamia e Nazareshës është ndërtuar që në vitin 1599 dhe në të ende vazhdojnë të realizohen shërbesa fetare. Restaurimi i saj vjen në një periudhë kur edhe një tjetër objekt i rëndësishëm për besimtarët myslimanë, pritet të konkretizohet. Bëhet fjalë për ndërtimin e xhamisë së Ballies, punimet për ndërtimin e të cilës kanë nisur dhe që shumë shpejt priten ti shtohen si vlera të rëndësishme Komunitetit Mysliman dhe Elbasanit në tërësi.

Xhamia e Nazareshës është një prej objekteve të kultit më të rëndësishëm jo vetëm në Elbasan, por edhe më gjerë, pas restaurimit kjo xhami nuk do të shërbejë vetëm për shërbesat fetare, por pse jo edhe për vizitorët që do të kenë interes të prekin nga afër një institucion fetar të ndërtuar më shumë se 400 vite më parë.





Hatërmbytja

nuk është një rrugë komunikimi

Pse njerëzit ofendohen kaq lehtë dhe preferojnë të mbajnë mëri?

Megjithëse të mbash mëri dhe të distancohesh nga personi përballë është një sjellje e cila rrjedh nga mosplotësimi i dëshirës së personit dhe konsiderohet si një mënyrë e ftohtë komunikimi. Të bësh atë që dëshiron dhe kur nuk e arrin t'ia imponosh tjetrit me anë të kësaj sjelljeje është një lloj dënimi i pales përballë. Personat që pasqyrojnë një sjellje të tillë janë të rritur të cilët akoma kanë mbetur në fëmijëri. Të mbajturit e mërisë brenda një marrëdhënieje bashkëshortore mund ta konsiderojmë si një ndalesë në komunikimin në çift, një ngirje të përgjegjësisë.

Kur i hedhim një sy dinamikës së hatërmbetjes vërejmë se njerëzit e përdorin si një mënyrë të shprehuri dhe fillojnë të zhvillojnë strategji të reja. Për shembull, personi i cili hedh hapin e parë përpiqet të zbusë komunikimin por kur vëren sjelljen agresive të personit përballë lodhet dhe fillon të distancohet nga ofenduesi. Pa mendojeni pak, përballë keni një person i cili vazhdimisht ofendohet lehtë dhe mban mëri për një kohë të gjatë, mban mëri kur nuk i plotësohet dëshira apo pritshmëria apo kur nuk arrin të shpjegojë veten. Si mund t'ia dilni me të? Ju nuk mund të duroni gjithmonë këtë sjellje dhe të kërkonit dalje në mënyrë të vazhdueshme.

Hatërmbetja nuk është një mënyrë komunikimi e të rriturve

Të rriturit duhet të zgjedhin mënyrën e komunikimit të drejtpërdrejtë, të ballafaqimit me problemin sepse kur zgjedhim mbajtjen e një qëndrimi ndryshe këpusim lidhjen, e ngrijmë atë dhe kjo gjë i hap rrugë problemeve kronike. Marrëdhënia është e barabartë me komunikim. Cilësia e komunikimit është cilësia e martesës. Sa më i forte të jetë komunikimi aq më e forte dhe e shëndetshme është marrëdhënia. Të mbajturit e mërisë e sëmur komunikimin dhe marrëdhënien.

Kush mban më shumë mëri ?

Të mbajturit e mërisë vihet re më shumë tek personat të cilëve nuk u plotësohen pritshmëritë. Këtë gjë e vëmë re edhe tek personat që nuk u është thënë asnjëherë jo por u është plotësuar çdo dëshirë. Edukimi i fëmijëve fillon me mendimin se në të ardhmen do të bëhen një bashkëshort, burrë, grua e rritur. Nëse ne përpiqemi t'i plotësojmë çdo dëshirë fëmijës dhe të bëjmë çfarë thotë ai në të ardhmen ky fëmijë do të mbajë mëri që në momentin e parë të përplasjes së mendimeve dhe ky gjest do të zërë një pjesë të madhe të jetës së tij. Këtu sjelljen e fëmijës duhet ta analizojmë si një mënyrë të shprehuri dhe jo si një ofendim. Mënyra e komunikimit duhet të jetë e formës 'nuk e bëj nëse mban mëri por nëse shprehesh dhe diskutojmë rreth kësaj mund të arrijmë një pike të përbashkët'. Në ditët e sotme ku dalin në pah familjet me focus fëmijën dhe ku familja bërthamë është në qendër të vëmendjes mund të përballemi me fëmijë të cilët nuk kanë energjinë e duhur të shprehur.

Ky faktor e shndërron mbajtjen e mërisë në një gjë të zakonshme dhe të përditshme. Në të vërtetë mbajtja e mërisë është një veprim i papërgjegjshëm. Pra ju nuk merrni përsipër përgjegjësinë e të shprehurit të ndjenjave dhe nuk harxhoni aspak energji për këtë. Pjesën kronike të sjelljes e përcaktojmë si egoizëm. Mban mëri kur nuk i plotësohet dëshira apo pritshmëria. Si mund të komunikoni me të pas një fare kohe?

Problemi kryesor i çifteve të sotëm është mungesa e komunikimit ose të shprehurit e gabuar. Siç e thamë

edhe më pare martesë është e barabartë me komunikim, komunikim mes burrit e gruas, komunikim gjatë fejesës, komunikim edhe gjatë procesit të ndarjes. Personat që arrijnë të shprehin, të shprehin mendimet dhe pritshmëritë, të ndajnë ndjenjat e tyre me të tjerët janë më pak të prirur për të mbajtur mëri. Nga ana tjetër nuk kërkojmë dy persona të pagabueshëm për një martesë të lumtur. Ne besojmë tek ekzistenca e personave që pranojnë gabimin, kërkojnë dalje dhe përpiqen të mos e përsërisin. Nuk është e nevojshme të jesh i pagabueshëm për të qenë i lumtur. Ne jemi njerëz dhe sigurisht që gabojmë dashur pa dashur. Ashtu siç kemi pasur gabimet tona kur kemi qenë të pamartuar ashtu do të kemi edhe pasi të martohemi. Por në vend të kërkimit të personave perfektë për një martesë të suksesshme duhet të përpiqemi të zvogëlojmë shpeshtësinë e gabimeve, të pranojmë ekzistencën e gabimit dhe të zhvillojmë sjellje rikoperuese. Duhet të kemi kujdes edhe në një pike, nuk është e thënë që kërkesa jonë të plotësohet menjëherë pasi është shprehur. Pikë së pari ne shprehim kërkesën apo mendimin tonë, mund të marrë përgjigje ose jo, të kuptohemi apo jo. Nuk do të heqim dorë nga e vërteta jonë për shkak të gabimit të palës përballë.

Mund të ofendohemi, të thyhemi madje edhe shumë ndonjëherë. E rëndësishme është shpeshtësia dhe vazhdimësia e kësaj sjelljeje. Nëse kjo ndodh shpesh atëherë ekziston një problem tjetër. Atëherë të mbajturit mëri shndërrohet në një sjellje e cila prish marrëdhënien bashkëshortore. Kur mbani mëri personi përballë jush shpeshherë nuk e kupton shkakun e mërisë. Dhe si rrjedhojë fillon të prodhojë alternativa të ndryshme si 'mos vallë i ka ngelur hatri për këtë apo për atë, kam bërë ndonjë gjë të gabuar apo është grindur me ndonjë tjetër?' Personi përballë nesh nuk është i detyruar të gjejë shkakun e mërisë nëse ne mbajmë mëri. Nëse ne mbajmë mëri atëherë duhet të pranojmë edhe pasojat e këtij veprimi.

Nëse meritë lidhen me një ngjarje shumë radikale dhe të jashtëzakonshme atëherë ndërmjetësimi mund të jape një efekt shërues dhe përmirësues. Por nëse meritë fillojnë e shpeshtohen dhe bëhen pjesë e jetës së përditshme atëherë çifti do përpiqet të vazhdojë lidhjen me ndihmën e ndërmjetësimit të të tjerëve. Si rrjedhojë krijohet një trekëndësh kronik. Në çdo hatërmbetje përsëriten të njëjta gjëra. Dhe çiftet qëndrojnë në paqe deri në grindjen apo hatërmbetjen e radhës. Në martesë e rëndësishme është zgjidhja e përbashkët e problemeve nga burri dhe grua. Zgjidhjet e ardhura nga jashtë janë momentale dhe shpëtojnë vetëm momentin. Nëse ne mbajmë shumë mëri atëherë duhet të pyesim veten 'pse mbaj kaq shumë mëri? pse nuk arrij të pajtohem apo të fal pas hatërmbetjes? Burimi kryesor i problemit është ky: përse kohë nuk vërejmë gabimet tona do të merremi me gabimet e pales përballë dhe të fokusohemi tek ata. Por asnjëherë nuk duhet harruar se asnjë grindje apo debat nuk fillon vetëm. Nëse ne merremi pak edhe me gabimet tona atëherëulet mundësia e përsëritjes së shpeshtë të hatërmbetjeve.

Cilat janë shkaqet e hatërmbetjeve në çift?

Vite më pare rastet e krizave ekonomike, varfërisë, dhunës në çift ishin më të shpeshta. Me kalimin e kohës dhe me ndryshimin e përparësive vëmë re se hatërmbetjet apo ofendimet e shpeshta kanë filluar të ndikojnë në jetën bashkëshortore. Në ditët e sotme konceptet si: vlerësim-zhvlerësim, respect-mosrespect, përkujdesje-indiferencë përbëjnë bazën e hatërmbetjes, personi i cili mendon se nuk vlerësohet, respektohet është më i prirur të shfaqë hatërmbetje.

Qurma

**NJË FRUT I
MREKULLUESHËM**



Hurma është një frut që përmendet si në Kuran ashtu edhe në Bibël dhe prezantohet si një simbol i pjellorisë dhe gjallërisë në Dhjatën e Vjetër. Dhjata e Re përmend njerëzit që dilnin me gjethe palme për ta takuar Jezusin kur ai po hynte në Jeruzalem (Gjoni 12:13), i cili nga të krishterët festohet si e diela e palmës. Shumë ajete në Kuran i referohen hurmave ndërsa numërojnë bekimet që i janë dhënë njerëzimit: "Dhe ka (ndër prodhimet që Zoti sjell si ushqim për ju në tokën e ringjallur) frytet e hurmës dhe rrushit, prej tyre ju nxirrni lëng dhe ushqim të mirë, të shëndetshëm. Me siguri në këtë ka shenja për njerëzit që arsyetojnë dhe kuptojnë." (16:67)

Vargu i mëposhtëm tregon një tipar të panjohur të hurmës që na tërheq vëmendjen:

E dhembja (e lindjes) e mbështeti atë te një trup i hurmës. Ajo tha: "Ah sa mirë ka qenë për mua të kisha vdekur para kësaj e të isha e harruar që moti!" E prej së poshtmi atë e thirri (Xhibrili): "Mos u brengos, Zoti yt bëri pranë teje një përrockë (uji)". E ti shkunde trupin e hurmës se do të bijnë ty hurma të freskëta. Ti pra, ha pi e qetësohu, dhe nëse sheh ndonjë prej njerëzve thuaj: "Unë kam vendosur heshtje për hir të Gjithëmëshirshmit, andaj asnjë njeriu sot nuk i flas!" (19: 23-26)

Ka shumë mençuri në udhëzimet e Allahut xh.sh. për Merjemen për të ngrënë hurma. Ishte një nga bekimet e ofruara për të lehtësuar lindjen e saj. Në vitet e fundit, një informacion i madh është marrë për rëndësinë dhe përfitimet e hurmave, veçanërisht për gratë që janë shtatzëna dhe gjatë lindjes. Përveç shuarjes së nevojave gjatë shtatzënisë, hurmat janë gjetur të jenë të dobishme në lehtësimin e lindjes, shmangien e proceseve të mundimshme kirurgjikale siç është prerja cezariene dhe plotësimin e nevojave të nënës dhe të porsalindurit.

Hurmat janë fruta gjithëpërfshirëse

Besohet se hurmat u rritën për herë të parë rreth 8,000 vjet më parë. Me kalimin e kohës, ato u zhvilluan në shtame të ndryshme, duke rezultuar në mbi 200 varietete të ndryshme me forma dhe shije të ndryshme. Sidoqoftë, hurmat ndryshojnë shumë pak në varësi të tokës dhe klimës në të cilën rriten për sa i përket sasisë së përbërjeve që përmbajnë si ushqim. Në varësi të varieteteve, 21-22% e hurmave është ujë, 1.7-2.2% karbon, 1.8-2.3% proteina, 0.4-0.6% yndyrna, 2.2-5.8% janë fibra, dhe 71-74% janë karbohidrate. Hurmat janë të pasura me një larmi të madhe të vitaminave, mineraleve, acideve yndyrore, enzimave, antocianinave, komponimeve fenolike, steroleve, karotenoideve, alkaloidëve, polifenoleve, taninave, acideve P-kumarike, terpenoideve, prokianidinave

dhe flavonoideve. Ato gjithashtu kanë aftësinë të heqin radikalet e lira dhe të lidhin metalet e rënda duke parandaluar kështu stresin oksidativ dhe inflamacionin. Metalloenzimet antioksiduese, të tilla si superoksid dismutaza dhe glutathione peroksidaza, luajnë një rol të rëndësishëm në shumë funksione biologjike në trup.

Taninat dhe alkaloidet janë përbërje shumë efektive për të parandaluar parazitët, bakteret, viruset dhe infeksionet e kërpudhave. Hurmat konsiderohen një ushqim i plotë dietik pasi ato përmbajnë yndyrna dhe aminoacide të veçanta si një burim i rëndësishëm karbohidrate, vitamina dhe proteina. Një kilogram hurma ka rreth 2850-3000 kalori.

Vitaminat

Beta karoteni, i cili ruhet si pararendës i 35 mg vitaminë A në 100 gram hurma, përmirëson shikimin dhe forcon rezistencën e trupit tonë, kockat dhe dhëmbët. Beta karoteni ka aftësinë të parandalojë kancerin duke kontrolluar molekulat që sulmojnë qelizat. Përveç kësaj, hurmat përmbajnë 0,08-0,13 mg Thiamine (B1); 0,13-17 mg Riboflavin (B2); 0,14mg Piridoksinë (B6); 20 mg Acid folik (B9); 3-17.5 mg vitaminë C; 0.2 mg vitaminë E dhe Niacin (B3) acid. Nevoja për acid folik gjatë shtatzënisë dyfishohet, kështu që është një vitaminë që gratë duhet ta marrin. Përveç kësaj, acidi folik është një vitaminë që luan një rol të rëndësishëm në prodhimin e aminoacideve, të cilat janë qeliza të reja të gjakut dhe blloqe ndërtimi në rinovimin e qelizave. Nivelet e pamjaftueshme të acidit folik mund të bëjnë që qelizat e kuqe të gjakut të bëhen më të mëdha se normale, por më të dobëta në funksion, gjë që sjell simptoma të anemisë. Vitamina B1 e gjetur në hurma ndihmon sistemin nervor të jetë i shëndetshëm, të shndërrojë karbohidratet në energji dhe të përdorë proteina dhe yndyrna ndërsa vitamina B2 ndihmon në djegien e proteinave, karbohidrateve dhe yndyrnave për të siguruar trupin me energji dhe rigjenerimin e qelizave. Shkencëtarët të cilët gjithashtu tërheqin vëmendjen ndaj stresit dhe efektit të lehtësimit të tendosjeve të hurmave besojnë se kjo është për shkak të llojeve të ndryshme të vitaminës B. Përveç kësaj, vlera ushqyese e hurmave rritet në sasi të konsiderueshme falë sasisë së fibrave që përmban (6.4 -11.5 %).

Mungesa e kaliumit zbulohet gjatë shtatzënisë për shkak të vështirësive të ndryshme fiziologjike, veçanërisht të përzier. Kaliumi, i cili është i bollshëm në hurma, ka një rëndësi të madhe në këtë drejtim, dhe gjithashtu është shumë i efektshëm në ruajtjen e ekuilibrit të ujit në trup.

Karbohidratet dhe sheqeri

Hurmat i japin trupit energji dhe gjallëri me karbohidratet e tij (73%). Një sasi e madhe e kësaj përbëhet nga glukozoza, fruktoza, karbohidratet e tjera të tilla si saharoza, ksiloza, manoza dhe laktoza, të cilat treten lehtë dhe janë të dobishme për trupin. Ka gjithsej 284 kalori në 100 gramë. Mjekët deklarojnë se grave shtatzëna duhet t'u jepet ushqim me fruktozë ditën kur lindin në mënyrë që të japin energji në trupin e dobët të nënës, të aktivizojnë hormonet e qumështit dhe të rrisin prodhimin e qumështit të gjirit në mënyrë që të ushqejnë të porsalindurin.

Humbja e gjakut gjatë lindjes shkakton rënie të niveleve të sheqerit në trup, dhe hurmat janë të rëndësishme për ruajtjen e niveleve të sheqerit dhe parandalimin e presionit të ulët të gjakut. Është veçanërisht e dobishme për njerëzit e dobët ose të lodhur falë vlerës së lartë të kalorive. Ky informacion zbulon urtësinë pas së cilës Allahu e udhëzoi Merjemen të hante hurma në mënyrë që t'i jepte asaj energji, gjallëri dhe qumësht gjiri që do të ishin të nevojshëm për të dhe për të porsalindurin e saj.

Efekti i tyre mbi riprodhimin dhe fertilitetin

Urtësia prapa ajetit në Kuran, në të cilën Merjemes i thuhet të hajë hurma të freskëta ndërsa lind Isain (a.s.), mund të lidhet me praninë e oksitocinës në këtë frut. Oksitocina është një hormon interesant i cili ka efekte fiziologjike në trupin tonë, veçanërisht gjatë lindjes. Lirimi i tij në trupat tanë është zbuluar se rritet kur shfaqen veprime dashurie dhe dhembshurie, për shembull, midis bashkëshortëve, prindërve dhe fëmijëve, duke ledhatuar kokën e fëmijës ose duke prekur njëri-tjetrin. Sidomos gjatë shtatzënisë, çlirimi i këtij hormoni mund të rritet duke trajtuar gratë shtatzëna me dhembshuri dhe dashuri. Prandaj, është e rëndësishme të ruhet paqja dhe qetësia midis bashkëshortëve që oksitocina të luajë rolin e saj në mënyrë që të arrihet një proces i shëndetshëm i shtatzënisë dhe lindje e lehtë.

Oksitocina është në thelb një hormon i sekretuar në tru që fillon dhimbjet e lindjes. Të gjitha përgatitjet e trupit para lindjes nxiten me këtë hormon. Pak para fillimit të dhimbjeve të lindjes, ka një rritje të numrit të receptorëve të oksitocinës në mitër dhe ky hormon luan një rol kyç në fillimin e kontraktimeve të muskujve të mitrës gjatë lindjes. Ky hormon, i cili stimulon tkurrjen e fortë të barkut të nënës, është jashtëzakonisht i rëndësishëm për lindjen. Përveç kësaj, mitra ngushton enët e gjakut dhe shkakton tkurrjet e muskujve që përdoren për të ndaluar gjakderdhjen menjëherë pas lindjes. Lehtëson ndarjen e placentës nga mitra. Ajo fillon

rrjedhën e qumështit në kanalet e gjëndrës, duke siguruar tkurrjen e qelizave epiteliale muskulare (mioepiteliale) që mbulojnë qelizat e gjëndrave të qumështit në gjinj.

Për mrekulli, prekja e foshnjës për të thithur gjirin e nënës është gjetur të kontribuojë në më shumë çlirim të oksitocinës dhe rritjen e sasisë së qumështit. Për më tepër, ai ul nivelin e kortizolit dhe presionin e gjakut në mënyrë që të zvogëlojë efektet e stresit që mund të shkaktohen nga frika e lindjes. Sigurisht, presioni i ulët i gjakut gjithashtu do të zvogëlojë gjakderdhjen. Dy përfitime të tjera janë se ajo ka një efekt përsheptues në shërimin e lezioneve dhe ndihmon në humbjen e peshës.

Përdorimi i hurmave për infertilitetin

Hurmat janë përdorur për të trajtuar infertilitetin për shekuj, dhe studimet tani po tregojnë se poleni i marrë nga pemët e hurmave mashkullore mund të jetë arsyeja pse. Këto studime të kryera deri më tani mbështesin idenë se hurmat mund të rrisin pjellorinë mashkullore dhe femërore me mikroelementë të izoluar nga estrogjeni dhe sterolët. Në një studim, poleni i hurmës u raportua për të përmirësuar lëvizjen dhe qëndrueshmërinë e spermës së bashku me reagimin akrosomik në kokën e spermatozoidit. Në një studim tjetër, poleni i hurmës mashkullore është treguar të shkaktojë një rritje të peshës së organeve riprodhuese të femrave dhe një rritje të sasisë së testosteronit në serum, peshës së testikujve, numrit të spermatozoideve dhe cilësisë tek burrat. Në minjtë meshkuj të ushqyer me fara hurme, ishte zbuluar një rritje e konsiderueshme e testosteronit dhe e hormoneve luteinizuese. Në një studim tjetër, vaji i farave të hurmës kishte një rol të rëndësishëm në rritjen e numrit të spermatozoideve, lëvizshmërisë dhe qëndrueshmërisë tek minjtë meshkuj. Në një studim tjetër që përfshinte minjtë që ushqeheshin me hurma, u zbulua se nivelet e hormonit të oksitocinës u rritën dhe treguan efekte anësore pozitive në muskujt e mitrës. Përveç kësaj, një studim zbuloi se ekstrakti i polenit të hurmës ishte efektiv në një rritje të konsiderueshme të numrit dhe lëvizshmërisë së spermës, hormonit luteinizues, testosteronit dhe niveleve të estradiolit në serum.

Me hulumtimet e reja, aspektet pozitive të antioksidantëve në hurma, siç u shpjegua më lart, po fiton më shumë terren në komunitetin shkencor. Një studim i fundit ka treguar se konsumimi i hurmave lehtëson relaksimin në qafën e mitrës, rrit integritetin e membranave mbrojtëse të embrionit, zvogëlon ndjeshëm si fazën e parë dhe të dytë të shtatzënisë dhe shkakton një rritje të ndjeshme të normave normale të lindjeve.

Përktheu: Erion Sukaj



Pëllumbat e shpellës

Ishte një pasdreke mjaft e nxehtë. Dielli i shkretëtirës i ngjente në alle kodërzat e rërës përreth. Mes kodërzave ndodhej një oaz. Rreth atij burimi të vogël uji kishin mbirë e radhatur një sërë drurësh hurme. Degët e tyre të ngarkuara me hurma vareshin gjer përdhë. Me ngjyrën e tyre të verdhë në të artë, veshulët e hurmave dukeshin shumë të shijshme. Mbi degët e njërës prej drurëve ndodhej një fole pëllumbash.

Pëllumbat prindër i kishin marrë të vegjlit nën krahë. Pak më parë kishin ngrënë të gjithë së bashku dhe tani po preheshin të ngopur. Ata po sodisnin diellin që pasqyrohej mbi ujë. Sytë e pëllumbit nënë, pëllumbeshës, ishin kredhur në largësi. Pëllumbi baba, i cili e vuri re, e pyeti bashkëshorten:

"Gu-gu, Pëllumbeshë! Prapë u krodhe në mendime! Ç'po mendon ashtu?"

"Eh", tha ajo duke rënkuar thellë. "Ti e di se ç'po mendoj, ore burrë! Gu-gu!"

Pëllumbi tundi kokën rëndë-rëndë.

"E di", tha duke buzëqeshur, "si nuk e di? Po mendon sërish për ato ditë të bukura,

prapë!"

"Asnjë çast s'më hiqen nga mendja. Me përfytyrimin e tyre jetoj! Gu-gu!"

Të vegjlit e tyre, Hirushi dhe Larushi kishin vetëm ca ditë që kishin dalë nga veza. Ata s'dinin gjë për të kaluarën e prindërve të tyre. Ata u bënë shumë kureshtarë nga biseda e prindërve. Megjithëse kishin vetëm pak ditë që kishin ardhur në jetë, ata e kishin kuptuar se prindërit e tyre kishin një vend të veçantë mes zogjve dhe shpendëve të tjerë të atyre anëve.

Një ditë më parë, sorkadhet që kishin zbritur në breg të oazit, seç bisedonin dhe bënë me shenjë nga çerdhja e tyre. Kurse shqiponja që po fluturonte në kupë të qiellit, në çdo rrotullim, u thoshte: "Ju lumtë! Ju lumtë!"

Shkurt, të gjitha kafshët i përshëndesnin dhe përpiqeshin me sa kishin mundësi të mos i ngacmonte gjë.

Hirushi dhe Larushi nuk e kuptonin pse kafshët e tjera i vlerësonin kaq shumë. Një ditë menduan se kishte ardhur koha t'i

pyesnin.

Me zërin e tij të hollë, Hirushi e pyeti t'ëmën:

"Mami, të lutem, më thuaj pse na duan kaq shumë kafshët, pse hiqen menjëherë mënjane kur shkojmë për të pirë ujë dhe pse na përshëndesin me aq respekt?"

Nëna e mori sërish nën krahë me dashuri të voglin e saj, ia përkëdheli kokën me dhembshuri dhe iu drejtua me buzëqeshje të shoqit:

"Më duket se erdhi koha t'ua tregojmë çdo gjë fëmijëve! Ç' thua ti?"

"Po, këta u rritën aq sa të kuptojnë, pra, le t'ua tregojmë!"

Nëna e mori nën krahë edhe Larushin dhe nisi të tregojë:

"Ah, more bij, le të flasim më parë pak për Zotin. Si çdo gjë tjetër, edhe neve, Ai na ka krijuar. Ne jemi krijesat e Tij. Çdo ditë Ai na e siguron ushqimin, kurse ne e gjejmë, e marrim dhe e hamë. Ai lëshon nga retë në qiell shi, kurse ne e pimë."

"Pa shihni, more fëmijë", tha babai, "sa krahë të bukur e plot pendë ngjyra-ngjyra na ka dhënë Zoti! Ne hapim krahët e fluturojmë në qiellin blu, kurse me sqepin gjejmë ushqim dhe pastrojmë pendët. Pastaj..."

"O, babi...", thirri Larushi, "unë sot i pastrova pendët, por sqepi nuk më arriti gjer te koka. Ç'duhet të bëj?"

"Bashkë me vëllanë, mund t'ia pastroni kokën njëri-tjetrit. Ndihma për njëri-tjetrin është gjë e mirë!"

Nëna e qortoi Larushin butë:

"I vogli im! Nuk duhet t'ia presësh fjalën babait! Duhet ta presësh të mbarojë, pastaj ta pyesësh. Kështu është më mirë!"

"Mirë, nënë", tha Larushi i bindur.

Babai vazhdoi:

"Sado ta falënderojmë Zotin tonë, është pak. Ai na do shumë. Edhe ne e duam shumë Atë!"

Larushi tha:

"Babi, ti flet shumë bukur. Por akoma nuk na ke treguar se pse kafshët e tjera na vlerësojnë kaq shumë. A s'u ka dhënë Zoti edhe atyre të mira si ne?"

Pëllumbi baba iu përgjigj duke buzëqeshur: "Gu-gu! Bëj durim, vogëlush! Mësimi kërkon durim. Do t'ju tregoj! Unë dhe nëna juaj, veç të mirave që marrin të gjitha kafshët nga Zoti, kemi marrë edhe një të mirë tjetër."

Pëllumbesha nuk duroi dot më. Me lotë lumturie në sy, tha:

"Edhe sikur të më jepej mundësia të jetoja miliona vjet në pyje të mbushur me gjelbërim, nuk do ta kisha ndërruar me ato ditë! Zoti ynë na fali një mirësi të madhe!"

Duke kërcyer me padurim nga vendi, Larushi e pyeti nënën:

"Mami, po ç'ndodhi, pra, ato ditë?"

"Pamë Profetin, o bir!..."

Pëllumbi dhe Pëllumbesha ishin prekur thellë nga kujtimet. Ata qanin me shpirt. Pas pak u qetësuan dhe Pëllumbi vazhdoi të tregojë.

"Nuk e harroj kurrë. Ishte vite më parë. Unë dhe nëna juaj ishim ende shumë të rinj. Ishte përsëri një ditë e nxehtë si kjo. Ne po fluturonim mbi kodrat e rërës. Ndërkaq, nga Zoti na erdhi një urdher. Ne duhet të bënim një fole mu në hyrje të shpellës së quajtur Thevr. Me ta marrë urdhrin, përplasëm krahët me tërë fuqinë dhe fluturoam për në shpellë. Pa pushuar, në hyrje të saj ndërtuam fole."

Nëna u ngashërye sërish dhe tha:

"Gu-gu! Mu atëherë dëgjuam zëra nga brenda. Kthym kokën, por ç'të shihnim? Brenda ishin i Dërguari i Zotit, profeti Muhamed, dhe shoku i tij, Ebu Bekri. Atë çast m'u duk se do të më ndalej zemra nga gazëllimi!"

Larushi pyeti me kërkshëri:

"Mirë, moj mami, po si e njohët Profetin ju?"

Nëna qeshi.

"Vogëlushi im! Atë e njohin të gjitha gjallesat, madje edhe jogjallesat. Ai i thërret pemët dhe ato i shkulin rrënjët e i shkojnë pranë. Merr gurë në dorë dhe gurët fillojnë e luten për të. Retë i bëjnë hije. Ai ka një bukuri të tillë në fytyrë që, sapo ta shohësh, dashurohesh pas saj. Ai është i Dërguari i Zotit. Ashtu siç kanë bërë edhe profetët e tjerë, ai na e bën të njohur Zotin e na flet për Të. Ai u tregon njerëzve për të gjitha cilësitë dhe shprehitë e moralit të bukur. Në saje të mësimave të tij, myslimanët, me të na parë neve, mendojnë për ne, për krijimin tonë. Ata kurrë nuk na bëjnë ndonjë të keqe, por na mbrojnë. A e mban mend se ç'ndodhi dje kur re nga foleja? Të gjithë ne po bërtisnim nga tmerri, kur ty të dalloj një mysliman që në atë kohë po i jepte devesë ujë. Ai u afrua, të mori në duar me përkëdheli, tha "sa të bukur e ka bërë Zoti", të puthi dhe të vuri në fole pa të shkaktuar asnjë dëm. Duke të vënë, tha "bismil'lah". Sa u gëzuam ne për këtë sjellje, apo jo!"

"Po, nënë", tha ai. "Ai xhaxhi u soll shumë mirë me mua. Dhe këtë ia paskua mësuar profeti Muhamed! Unë tani do ta dua më shumë atë!"

Pëllumbi baba vazhdoi:

"Por sa keq që ka nga ata që nuk ia dëgjojnë fjalën atij! Ata na quajnë ne qenie të pavlera, që ekzistojmë pa ndonjë qëllim, nuk u vjen keq për ne, prandaj edhe na shajnë

dhe na bëjnë keq!"

"Ja, pra, të vegjlit e mi", tha nëna, "atë ditë, Profeti me Ebu Bekrin ndodheshin në shpellë. Ata po mërgonin, po largoheshin nga Meka për në Medine."

Duke i hapur sytë me kërshtëri, Larushi pyeti:

"Po pse i linin shtëpitë e iknin?"

"Kushërinjtë tanë të Mekës na treguan se ç'kishte ndodhur. Idhujtarët kurejshë të Mekës u bënë shumë të këqija myslimanëve. Ata përpiqeshin t'i detyronin myslimanët të hiqnin dorë nga besimi islam. Prandaj myslimanët, me leje të Allahut dhe të Dërguarit të Tij, kishin filluar të largoheshin për në Medine."

"Ky largimi quhet hixhret. Idhujtarët dashkan ta pengojnë edhe hixhretin e myslimanëve!"

"Po pse idhujtarët s'duan që myslimanët të mërgojnë? A na thatë se nuk i duan myslimanët e u bëjnë shumë të këqija?"

"Sepse idhujtarët paskan frikë nga bashkimi i myslimanëve me medinasit dhe fuqizimi i tyre! Ata shqetësohen se mos një ditë Profeti Muhamed vihet në krye të tyre dhe i sulmon. Idhujtarët paskan bërë një mbledhje ku, me propozimin e Ebu Xhehlit, paskan vendosur ta vrasin Profetin. Pastaj, një natë, e paskan rrethuar shtëpinë e tij, por Allahu e paska njoftuar. Profeti paska vënë Aliun në shtratin e vet dhe paska dalë nga shtëpia duke kaluar para syve të tyre!"

"Pa e parë ata?"

"Pa e parë, vogëlushi im, sepse, kur Allahu s'do, askush nuk mundet të shohë. Dhe, kështu, pasi kishin pritur gjithë natën rreth shtëpisë së Profetit, idhujtarët ishin habitur kur kishin parë Aliun të dilte që atje!"

Nëna mori pak frymë dhe vazhdoi:

"Ndërkaq, Allahu e kishte urdhëruar të Dërguarin e Tij të mërgojë. Ai u mor vesh me Ebu Bekrin dhe u nisën. Shkuan në fillim në shpellën Theur ku u fshehën. Ja, pra, atëherë ne e bëmë folenë tonë mu në hyrje të shpellës që ishte si një vrimë e madhe. Një motra jonë merimangë thuri një rrjetë të madhe me të cilën e zu tërë hyrjen e shpellës. Gjatë kësaj kohe, idhujtarët ishin vënë pas Profetit dhe Ebu Bekrit."

Larushit i kishte mbetur sqepi hapur nga habia.

"Kështu, ë?", tha ai me habi. "Dy pëllumba dhe një merimangë kundër gjithë atyre burrave të armatosur!"

"Mirë, po ç'ndodhi atje, moj nënë?", pyeti Hiroshi duke përplasur krahët e vegjël.

Nëna iu përgjigj:

"Idhujtarët i qenë afruar shumë shpellës.

Ebu Bekri ishte shqetësuar. Ai kishte frikë se mos idhujtarët i bënë ndonjë të keqe Profetit. 'O i Dërguari i Allahut', i kishte thënë ai Profetit, 's'më vjen keq po të më vrasin mua, por, mos e dhëntë Zoti, po të të bëjnë keq ty, kjo gjë do të sillte shkatërrimin e të gjithë bashkësisë së myslimanëve!' Kurse Profeti ishte i qetë. Ai u përpoq ta qetësonte Ebu Bekrin duke i thënë: 'Mos u dëshpëro, Allahu është me ne!'. Por ai i tha: 'O i Dërguari i Allahut, po qe se ndonjë prej tyre përkulet dhe sheh brenda në shpellë, na dallon nga këmbët që jemi këtu! I sigurt në vetvete, Profeti u përpoq sërish për ta qetësuar Ebu Bekrin duke i thënë: 'O Ebu Bekr! Mos u mërzit e mos u shqetëso se Allahu është me ne!' Pastaj bëri lutje që Allahu ta qetësonte atë!

Idhujtarët e kishin parë folenë tonë dhe rrjetën e merimangës dhe, duke menduar se aty s'do të kishte njerëz, ishin larguar."

Duke i shkëlqyer sytë, Larushi pyeti:

"Mirë, moj nënë, po sa ndenjen ata në shpellë?"

"Tri ditë e tri net, vogëlushi im! Pastaj atje shkoi një prijës me dy kuaj dhe ata u larguan."

Pëllumbi baba i pa fëmijët në sy me kujdes dhe u tha:

"Ja, kështu, vogëlushët e mi! Unë me nënën tuaj kurrë s'kemi për t'i harruar ato tri ditë të bukura! Ne jemi shumë të lumtur që e pamë Profetin, e shoqëruam dhe bëmë roje për të!"

Larushi tha tërë mërzitë:

"Mirë, po ne nuk e pamë dot!"

"Ashtu është, por edhe ju, po të bëni siç na këshillon ai, edhe do të fitoni pëlqimin e Allahut, edhe do ta shihni atë në xhenet."

Nëna pëllumbeshë tha:

"Ka vite që njerëzit na përmendin ne duke na treguar si shembull se, me anë të qenieve të dobëta, Allahu mund t'i shkatërrojë edhe ata që duken si shumë të fuqishëm!"

Pëllumbi baba shtoi:

"Vogëlushët e mi, ne presim nga ju që të jetoni sipas urdhrave që Allahu, Zoti ynë, na i ka bërë të ditura me anë të të Dërguarit të Tij, Profetit Muhamed. Kështu, jeta juaj kthehet në xhenet dhe fitoni kënaqësinë e Allahut dhe të Profetit!"

Në folenë e pëllumbave majë degëve të një druri hurme, mori fund një bisedë e ëmbël. Me perëndimin e diellit, qielli u mbush plot yje. Nën vezullimin e yjeve të shkretëtirës, pëllumbat u përqaftuan me njëri-tjetrin dhe ranë në një gjumë të lumtur.

Në ëndërr, Profeti u buzëqeshte, i merrte në dorë dhe i përkëdhelte me dashuri.



**Me të vërtetë, në këtë
(Kuran) ka mësim të
mjaftueshme për ata që
(e) adhurojnë (Allahun).**

(Kuran, 21:106)

”

2021

PROGRAMET

Cikli i Parë

KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR



- ✓ Drejtësi (5-vjeçar)
- ✓ Shkenca Komunikimi (Gazetari)
- ✓ Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu
- ✓ Gjuhë dhe Letërsi Angleze 
- ✓ Shkenca Islame 
- ✓ Informatikë Ekonomike 
- ✓ Shkenca Kompjuterike
- ✓ Teknologji Informacioni dhe Komunikimi
- ✓ Programim në Web (2-vjeçar)
- ✓ Multimedia dhe Dizajn Grafik (2-vjeçar)

kontakt:

Ju mund të shfaqni interesimin tuaj,
duke plotësuar formularin në
faqen e Zyrës së Pranimeve:
admission.beder.edu.al

Regjistrimi për Programet
e ciklit të parë



+355 67 34 27 001

www.beder.edu.al

